



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 47 regjistër (JR)
Datë 19.10.2023

Nr. 92 i vendimit
Datë 15.12.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 15.12.2025, ditën e hënë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 47/2023 (JR), datë 19.10.2023, që i përket:

ANKUES: Komisionerja Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 689, datë 24.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ervin Pollozhani.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2 dhe neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtoi pretendimet e Komisioneres Publike Irena Nino, të

paraqitura në ankim, si dhe parashtrimet e konkluzionet përfundimtare të paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i përfaqësuar me autorizim¹ në gjykim nga prokurori Klodjan Braho, të cilët kërkuan ndryshimin e vendimit nr. 689, datë 24.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ervin Pollozhani, shqyrtoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit dhe avokates së tij Romina Zano, të cilët përfundimisht kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ervin Pollozhani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë², me konstatimet se:

- (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. AKSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 31.10.2017, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 17.06.2022, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ervin Pollozhani*.

¹ Autorizim “Për përfaqësimin e çështjes në seancë publike”, nr. {***} prot., datë 22.10.2025.

² ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.10.2018, ka përcjellë në Komision: “aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ervin Pollozhani, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.

2.3. KLGj-ja, pas rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 689, datë 24.07.2023, në bazë të nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi konkludoi se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ervin Pollozhani, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*
4. Komisioni e ka mbështetur vendimin e mësipërm në konkluzionet e arritura mbi të tria kriteret e rivlerësimit, duke konkluduar për secilin prej tyre, si vijon.

4.1. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë⁴: “[...] Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim, ose në përdorim të tij dhe personave të lidhur. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaram nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara si më sipër, nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësisë. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016”.

³ KLGj-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.11.2021, ka përcjellë në Komision: “Raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Ervin Pollozhani”.

⁴ Paragrafi 28 i vendimit të Komisionit.

4.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës⁵: “[...] Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës”.

4.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale⁶: “Si përfundim, në analizë të raportit të hartuar nga KLGj-ja, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të përsëritura e të qenësishme të natyrës procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, të kërkuar nga ligji nr. 84/2016”.

III. Shkaqet e ankimit

5. Komisionerja Publike Irena Nino (në vijim “Komisionerja Publike”) ka paraqitur ankimin nr. {***} prot., datë 11.10.2023⁷, kundër vendimit nr. 689, datë 24.07.2023, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Ervin Pollozhani.

Komisionerja Publike, mbështetur në kompetencën kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 689, datë 24.07.2023, të Komisionit, ka çmuar se ai përmban shkaqe ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

Komisionerja Publike ka konsideruar se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruara, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

5.1. Komisionerja Publike, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 4 dhe 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar që shkaqet e ankimit të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 689, datë 24.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ervin Pollozhani.*

6. Shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike renditen, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

6.1. Për pasurinë “apartament me sipërfaqe 99,7 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë”, vlerësimi i kryer nga Komisioni është i pabazuar në ligj dhe në prova. Sipas Komisioneres Publike, sa i përket të ardhurave që kanë shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, ato mbesin në nivel deklarativ dhe nuk provohet ligjshmëria e tyre. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka kryer deklaram të pasaktë dhe të

⁵ Paragrafët 34-35 të vendimit të Komisionit.

⁶ Paragrafët 42-43 të vendimit të Komisionit.

⁷ Ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, neneve 33, pika 5, shkronja “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

6.2. Për pasurinë “likuiditete *cash*” në shumën 1.000.000 lekë deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit: (i) subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur nuk kanë deklaruar shtesa apo pakësime të likuiditeteve *cash* në deklaratat e interesave për vitet 2006-2015; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar gjendje likuiditeti *cash* në fund të vitit 2012, në shumën e pretenduar prej 1.446.000 lekësh, derivat i shumës prej 4.446.000 lekësh. Edhe vetë shuma prej 4.446.000 lekësh e kthyer nga shoqëria “{***}” ShPK nga pagesa e kryer për blerjen e apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, sipas Komisioneres Publike, nuk konsiderohet si shumë e krijuar me burime të ligjshme, pasi nuk është deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën përkatëse të interesave, si dhe për shkak se buron nga pagesa e apartamentit, e cila nuk është kryer me të ardhura të krijuara nga burime të ligjshme nga personi i lidhur dhe prindërit e saj. Në këto kushte, këto kursime të pretenduara nuk mund të kenë shërbyer si burim të ardhurash të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit dhe krijimit të likuiditeteve *cash*, në shumën 1.000.000 lekë, në fund të vitit 2016, për rrjedhojë subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjaftueshmëri financiare për këtë vit.

6.3. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me shpenzimet e mobilimit të apartamenteve në pronësi të tij, referuar deklarimeve përkatëse të interesave. Lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të këtyre shpenzimeve, bazuar në deklaramet e subjektit të rivlerësimit, rezulton se shpenzimi në shumën 10.336 euro, në vitin 2015, ka si burim krijimi të ardhurat nga shitja e apartamentit, në rrugën “{***}”, Tiranë, ndërsa shpenzimet në shumën 1.000.000 lekë në vitin 2016 kanë si burim krijimi pakësimin e kursimeve *cash*. Sipas Komisioneres Publike, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provojnë mbulimin me burime të ligjshme të apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, çka afekton dhe ligjshmërinë e shumës 10.336 euro, deklaruar si burim financiar për përballimin e shpenzimeve për mobilim në vitin 2015. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kursimet *cash* ndër vite, për rrjedhojë edhe për shpenzimet e mobilimit për të dy apartamentet.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisioneres Publike dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, në përputhje me arsyetimin në vijim në këtë vendim.

b) Legjitimimi i ankuesit

8. Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisioneres Publike ndaj vendimit të Komisionit nr. 689, datë 24.07.2023, për subjektin e rivlerësimit Ervin Pollozhani, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.
10. Në seancën gjyqësore të datës 28.10.2025, trupi gjykues vendosi kalimin procedural nga Komisionerja Publike te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Civile.
11. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, në seancën e datës 28.10.2025, vendosi të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur parashtrimeve.
12. Në kuadër të denoncimeve nga publiku të depozituara në Kolegji, vënë në dispozicion paraprakisht subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në seancën gjyqësore të datës 28.10.2025, subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtrime, si dhe aktet shkresore në mbështetje të tyre, të administruara në cilësinë e provës, duke pretenduar se rrethanat e parashtruara nga denoncuesit janë të pabazuara. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pasi u njoh me parashtrimet e subjektit të rivlerësimit mbi denoncimet, në të njëjtën seancë gjyqësore, parashtrroi se denoncimet e përcjella nga publiku nuk përmbajnë ndonjë rrethanë, që të ndikojë në procesin e rivlerësimit. Trupi gjykues, pasi dëgjoi pretendimet e palëve në gjykim, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos vijojë me hetimin e mëtejshëm gjyqësor të denoncimeve, pasi arriti në konkluzionin se ato nuk plotësonin kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.
13. Në përfundim të seancës gjyqësore publike të datës 28.10.2025, trupi gjykues deklaroi të mbyllur hetimin gjyqësor të çështjes dhe vendosi kalimin në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare.

c/1 Akti “Gjetje dhe opinion” i vëzhguesit ndërkombëtar

14. Në seancën gjyqësore të datës 11.11.2025, vëzhguesi ndërkombëtar, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pikat 10 dhe 11 të ligjit nr. 84/2016, depozitoi aktin “Gjetje dhe opinion”, nr. {***}. prot., datë 10.11.2025.

14.1. Në gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar ka renditur faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, sipas së cilave, më datë 18.09.2007, znj. A. Ç. (bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në atë kohë e dashura e tij) ka nënshkruar një kontratë sipërmarrje me shoqërinë e ndërtimit “{***}” ShPK, për një apartament në Tiranë, me vlerë prej 117.000 eurosh ose 14.467.050 lekë, çmim i paguar plotësisht nga znj. Ç.. Më datë 20.01.2012, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie me çmimin e përcaktuar në vlerën 84.000 euro ose 11.700.000 lekë. Në të njëjtën datë, administratori i shoqërisë “{***}” ShPK ka nënshkruar një deklaratë noteriale ku deklaroi se subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij u është kthyer shuma prej 4.460.000 lekësh, e cila u është dhënë në dorë. Kjo shumë e konvertuar në euro është 32.243 euro. Sipas vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të këtyre të dhënave, kostoja reale e apartamentit është 84.813 euro. Në deklaratën e rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se ka investuar, në periudhën 2008-2014, shumën prej 586.000 lekësh, për mobilimin e këtij apartamenti. Më datë 28.08.2014, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij e kanë shitur këtë pasuri për çmimin 130.000 euro ose 18.122.000 lekë. Për një periudhë prej 2 vite e gjysmë, ata kanë pasur një fitim prej 5.836.000 lekësh. Në këndvështrimin e Vëzhguesit Ndërkombëtar, ky përfitim i jashtëzakonshëm duket i dyshimtë dhe justifikon nevojën për hetim të mëtejshëm.

14.2. Në opinionin i cili vijonte gjetjen, vëzhguesi ndërkombëtar ka parashtruar veprimet hetimore, të cilat i çmoi të nevojshme të kryheshin nga Kolegji dhe që konsistonin në dëgjimin si dëshmitar të administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, kërkimin e të gjithë librave dhe regjistrave pjesë e kontabilitetit të kësaj shoqërie në lidhje me pasqyrimin e rimbursimit ndaj subjektit të rivlerësimit të shumës prej 4.460.000 lekësh, kërkimin e një kopjeje të të gjitha kontratave të sipërmarrjes të të gjitha apartamenteve të ndodhura në godinën ku gjendet apartamenti objekt kontrolli dhe kopje të kontratave të mëpasshme të shitblerjeve me pronarët e parë, si dhe verifikimin pranë gjykatave përkatëse ku subjekti i rivlerësimit është caktuar në detyrën e gjyqtarit, nëse blerësit e kësaj pasurie ose personat e lidhur me ta, janë të përfshirë në çështje penale apo civile përpara vitit 2015.

14.3. Trupi gjykues i Kolegjit njohu palët pjesëmarrëse në gjykim me aktin “Gjetje dhe opinion” të vëzhguesit ndërkombëtar dhe dëgjoi parashtrimet e tyre në seancën publike të datës 14.11.2025.

14.3.1. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke marrë në konsideratë se shuma prej 4.446.000 lekësh është deklaruar si e kthyer nga pagesa e bërë për apartamentin për të cilin nuk provohet se mbulohet me burime të ligjshme dhe se kjo shumë ka shërbyer si burim krijimi për pasuri në pronësi të subjektit të rivlerësimit, të deklaruar nga ky i fundit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe të trajtuara në ankim, vlerësoi se gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë me çështjet e trajtuara në ankimin e ushtruar për subjektin e rivlerësimit

dhe për pasojë e vlerësoi të drejtë dhe të bazuar ligjrisht nevojën për të ndërmarrë veprime të mëtejshme hetimore nga Kolegji.

14.3.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi aktin “Gjetje dhe opinion” i vëzhguesit ndërkombëtar, duke argumentuar, në mënyrë të përmbledhur, se ankimi i Komisioneres Publike është bërë në mungesë të një rekomandimi për ankim nga ana e përfaqësuesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Kjo do të thotë se tashmë çdo shkak apo pretendim ka rënë në dekadencë, për sa kohë nuk është bërë brenda afateve të përcaktuara në ligj, konkretisht brenda afatit 15-ditor. Megjithëse ligji i posaçëm nr. 84/2016 nuk parashikon afate të veçanta për paraqitjen e “gjetjeve” nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, kur një gjetje paraqitet në momentin e mbylljes së hetimit gjyqësor, atëherë bëhen të zbatueshme rregullat dhe dispozitat procedurale që përcaktohen në Kodin e Procedurës Civile. Kjo do të thotë se çdo kërkim procedural në këtë fazë të procesit mund të merret vetëm nëse Kolegji vendos të riçelë hetimin gjyqësor në kuptimin e nenit 465/3 të Kodit të Procedurës Civile dhe vetëm nëse plotësohen kushtet strikte të nenit 465/5 të të njëjtit Kod. Gjetja nuk përmbush standardin e kërkuar nga kjo dispozitë, pasi nuk provon asnjë nga situatat e përcaktuara në të. Prandaj, edhe në mungesë të një afati të posaçëm për gjetjen, koha kur ajo paraqitet e vë atë nën regjimin e riçeljes dhe filtrat e nenit 465/5 të Kodit të Procedurës Civile. Nëse këto nuk përmbushen, Kolegji nuk mund ta administrojë gjetjen si provë në këtë fazë, por vetëm të vijojë gjykimin, brenda kufijve të ankimit dhe të provave të formuara ligjrisht, gjatë fazës së hetimit administrativ dhe gjyqësor në gjendjen që ato janë. Provat që kërkohen të merren, përveçse nuk plotësojnë kërkesat e pikës 5 të nenit të sipërcituar, referojnë edhe shkak të ri ankimi, duke cenuar kështu parimin në *ultra petita*. Zgjerimi i shkaqeve të ankimit të paraqitura tej afateve ligjore do të cenonte parimin e procesit të rregullt ligjor, mbrojtjes efektive dhe barazisë së armëve. Në bisedimet përfundimtare në seancën gjyqësore të datës 25.11.2025, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar shuma e kthyer nga shoqëria sipërmarrëse është rritur nga 4.446.000 lekë në 4.460.000 lekë, si dhe janë përdorur kurse të ndryshe këmbimi valutor për të njëjtën datë 20.01.2012. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se nuk mund të pranohet konvertimi i çmimit të paguar prej 115.000 eurosh në 14.467.050 lekë, pasi vetë z. I. dhe znj. A. Ç. kanë pohuar e deklaruar në vite se shumën e paguar në euro e kanë realizuar nga konvertimi i shumës prej 13.800.000 lekësh në agjenci private të këmbimit valutor, sipas kursit 1 euro=120 lekë dhe kjo nuk është kontestuar në asnjë fazë të procesit. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar, gjithashtu, edhe konvertimin e shumës prej 11.700.000 lekësh në 84.000 euro, sipas vëzhguesit ndërkombëtar, duke argumentuar se me kontratën e shitblerjes së vitit 2012 nuk është rin negociuar një çmim i ri për apartamentin, si dhe nuk është kryer asnjë pagesë e re, por kjo shumë e finalizuar në kontratë në vlerën 11.700.000 lekë ishte pjesë e pagesës së kryer në shumën 115.000 euro, në vitin 2007. Për sa i përket shumës së kthyer nga shoqëria sipërmarrëse, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konvertimin e saj në euro në vlerën 32.243 euro, pasi ky konvertim nuk figuron në asnjë dokument, shkresë apo edhe deklaram. Lidhur me këtë shumë prej 4.446.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar qartësisht gjatë hetimit administrativ në Komision, në shkaqet që ndikuan kthimin e saj nga shoqëria sipërmarrëse, si: apartamenti përfundoi dhe u dorëzua me mbi 3 vite vonesë, nga afati i përcaktuar në kontratë prej 6 muajsh; në rakordimin final të sipërfaqes në metër katror u vu re se ajo nuk ishte 117 m², por 97,5 m², pra 19,5 m² më e vogël; disa punime

specifike të kërkuara nga personi i lidhur në porositje të apartamentit nuk u realizuan nga shoqëria dhe disa prej materialeve, ndonëse ishin porositur ndryshe, u realizuan me cilësi më të ulët. Nga sa më sipër, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka asgjë të re të lindur në datën 20.01.2012, përveç ndryshimit të kursit të këmbimit euro/lekë/euro nga viti 2007 në vitin 2012. Në deklaratimet e shoqërisë sipërmarrëse, pjesë e dosjes së hetimit administrativ, janë dhënë sqarime shteruese lidhur me shkaqet e kthimit të shumës, vlerën e saj dhe modalitetet e kthimit. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar, gjithashtu, se çmimi euro/m², sikurse në porositje dhe pagesën e apartamentit në shtator 2007 dhe në formalizimin e blerjes në janar të vitit 2012, është po i njëjti dhe i pandryshuar në 1.000 euro/m²=120.000 lekë/m², sa ka qenë kursi i këmbimit në kohën e porositjes dhe të kryerjes së pagesës në vitin 2007.

Lidhur me shumën 3.000.000 lekë të depozituar në llogari bankare, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në lidhje me këtë veprim thjesht teknik dhe arsyet e tij ka dhënë shpjegime specifike në deklaratat periodike të interesave private, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por edhe në pyetësorët e drejtuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, si dhe në seancën dëgjimore publike të zhvilluar atje. Të njëjtin qëndrim subjekti i rivlerësimit ka mbajtur edhe për shpenzimet e mobilimit, të referuara nga vëzhguesi ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se nuk mund të pranohet konkluzioni i vëzhguesit ndërkombëtar se familja e tij në një periudhë prej 2 vite e gjysmë ka realizuar një fitim prej 5.836.000 lekësh, jo vetëm për faktin se apartamenti me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë, u shit në vitin 2014 me çmimin e tregut pas 7 vitesh të porositjes dhe pagesës së çmimit të tij, por edhe për faktin se në këtë kohë u ble dhe apartamenti me sipërfaqe 99,7 m² në rrugën “{***}”, në Tiranë, duke mos pasur asnjë lloj përfitim monetar, por thjesht dhe vetëm shitja e një shtëpie në gusht 2014 dhe blerja e një shtëpie tjetër në shtator 2014, për vetëm 2,2 m² më shumë sipërfaqe banimi, apartamenti i vetëm në pronësi, ku dhe jeton aktualisht, familjarisht.

Subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje se sipas udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 04.04.2007, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “K” për vitin 2007”, rezulton se kostoja e shitjes për 1 m² sipërfaqe shfrytëzimi në tregun e lirë për qytetin e Tiranës është përcaktuar në vlerën 97.000 lekë, që dëshmon se çmimi i porositjes dhe i blerjes së apartamentit në rrugën “{***}”, në Tiranë, prej 120.000 lekë/m² është më i lartë se vlera e përcaktuar për qytetin e Tiranës, për atë vit. Sipas udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 06.08.2014, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2014”, rezulton se kostoja e shitjes për 1 m² sipërfaqe shfrytëzimi në tregun e lirë për qytetin e Tiranës është përcaktuar në vlerën 120.000 lekë. Në këtë mënyrë, ndërmjet çmimit të shitjes së apartamentit të parë dhe blerjes së të dytit, nuk mund të flitet për asnjë fitim, pasi dhe diferenca në dukje ndërmjet çmimit të të dyja pasurive është më e vogël se shpenzimet për mobilimin e apartamentit të ri.

Sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, sa më sipër, konsolidon koherencën e plotë të deklaratimeve të tij në çdo fazë të procesit.

15. Me vendim të ndërmjetëm, në seancën gjyqësore të datës 14.11.2025, në bazë të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 304 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues, në konsideratë dhe të

qëndrimeve të mbajtura nga palët, vendosi të riçelë hetimin gjyqësor vetëm në funksion të administrimit si dokument, të aktit “Gjetje dhe opinion” të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar dhe të mos vijojë me hetime të mëtejshme të sugjeruara nga ky opinion.

Ky qëndrim i trupit gjykues mori në konsideratë një sërë faktesh të shtjelluara në vijim për shkak të të cilave rezultoi se nuk ka vend të analizohet/vlerësohet përmbajtja e gjetjes dhe të çelet hetimi gjyqësor sipas opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar.

Së pari: Trupi gjykues çmon të theksojë se në mbështetje të nenit B, pika 3, shkronja “b” e Aneksit të Kushtetutës, si dhe parashikimeve nenit 49, pikat 10 dhe 11 të ligjit nr. 84/2016, vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë gjetje apo mendim, në çdo moment/kohë, pa kufizime të lidhura me ndonjë fazë procedurale të procesit të rivlerësimit, për një subjekt rivlerësimi.

Së dyti: Gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar (në vijim “gjetja”), në përmbajtjen e saj referon fakte të cilat lexohen në provat e administruara që gjatë hetimit administrativ në Komision, si më poshtë.

(i) Fakti i kthimit të shumës prej 4.446.000 lekësh subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, nga shoqëria “{***}” ShPK, në vitin 2012, nga pagesa e kryer në vitin 2007, për pasurinë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, i është nënshtruar verifikimit gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni. Për këtë qëllim, subjektit të rivlerësimit i janë drejtuar kërkesa për të dhënë shpjegime nëpërmjet pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 4 të drejtuar nga Komisioni, i është kaluar barra e provës në rezultatet e hetimit administrativ, si dhe i është përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga komisionerët dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së në seancën dëgjimore publike të zhvilluar në Komision;

(ii) Depozita bankare prej 3.000.000 lekësh e çelur në vitin 2012 në Credins Bank, e cila derivon nga shuma prej 4.460.000 lekësh e trajtuar në paragrafin më sipër në këtë vendim, është kontrolluar nga Komisioni në kuadër të hetimit administrativ për depozitën bankare në Credins Bank, të çelur në vitin 2016, pasuri kjo e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Hetimi i kryer nga Komisioni është pasqyruar në rezultatet e hetimit administrativ dhe në vendim;

(iii) Shpenzimet e mobilimit të dy apartamenteve në pronësi të njëpasnjëshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, janë hetuar nga Komisioni, në verifikim të deklarimeve të subjektit për to. Këto hetime janë materializuar nga Komisioni në pyetësorët drejtuar subjektit të rivlerësimit, si dhe në analizën financiare të rezultateve të hetimit administrativ, e cila është konfirmuar edhe në vendim;

(iv) Fakti i shitjes së pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë”, në vlerën 130.000 euro, ka rezultuar nga kontrata noteriale e shitblerjes së kësaj pasurie, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit si dokumentacion justifikues bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Ky fakt, si dhe mënyra e përfitimit të vlerës së sipërcituar (kalimi i vlerës së shitjes në llogarinë bankare të personit të lidhur, etj.) janë verifikuar nga Komisioni dhe veprimet hetimore të kryera për këtë qëllim dhe gjetjet e tyre janë pasqyruar në rezultatet e hetimit administrativ në formën e barrës së provës kaluar subjektit të rivlerësimit, për të cilat ai ka dhënë shpjegimet përkatëse, si dhe janë pasqyruar edhe në vendim.

Së treti: Gjetja, pasi rendit faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, lidhur me vlerën e blerjes dhe atë të shitjes së pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë”, i interpreton ato si të ndërlidhura, në funksion të konkluzionit se për një periudhë prej 2 vitesh e gjysmë subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur një fitim prej 5.836.000 lekësh, i cili në këndvështrimin e Vëzhguesit Ndërkombëtar është i jashtëzakonshëm dhe duket i dyshimtë, duke justifikuar nevojën për hetim të mëtejshëm.

Së katërti: Opinioni i vëzhguesit ndërkombëtar i lidhur ngushtësisht me përmbajtjen e gjetjes, rendit veprimet hetimore që kërkohen të kryhen nga Kolegji, në funksion të qartësimit të dyshimit të ngritur mbi vlerat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nga veprimet juridike të kryera të sipërcituara.

Së pesti: Ankimi i Komisioneres Publike është fokusuar në tre shkaqe, për të cilat ka kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit, si më poshtë.

(i) Në funksion të shkakut të ankimit, lidhur me kontrollin e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë “apartament me sipërfaqe 99,7 m² në rrugën “{***}”, në Tiranë”, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim financiar krijimi të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë”, Komisionerja Publike ka renditur faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, ndër të tjera, edhe lidhur me vlerën prej 130.000 eurosh përfituar nga shitja, kthimin e shumës 4.460.000 lekë subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur nga shoqëria sipërmarrëse, krijimin e depozitës prej 3.000.000 lekësh nga subjekti i rivlerësimit. Paraqitja e kësaj situatë faktike⁸ duket se vjen në funksion të argumentimit të detyrimit të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar burimet financiare të krijimit të kësaj pasurie nga personi i lidhur dhe prindërit e saj, konkretisht lidhur me të ardhurat e pretenduara se janë realizuar nga aktiviteti tregtar i familjes së personit të lidhur për periudhën 1998-2007, të ardhurat e pretenduara se janë realizuar nga personi i lidhur, si përkthyes pranë organizatave humanitare ndërkombëtare, si dhe të ardhurat e pretenduara se janë realizuar nga personi i lidhur si asistente mjeke promocioni pranë shoqërisë “{***}” ShPK.

(ii) Lidhur me shkakun e ankimit për likuiditetet në *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, Komisionerja Publike, ndër të tjera, ka argumentuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar gjendje likuiditeti *cash* në fund të vitit 2012, në shumën e pretenduar prej 1.446.000 lekësh, derivat i shumës prej 4.446.000 lekësh. Sipas Komisioneres Publike, edhe vetë shuma prej 4.446.000 lekësh e kthyer nga shoqëria “{***}” ShPK nga pagesa e kryer për blerjen e apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, nuk mund të konsiderohet si shumë e krijuar me burime të ligjshme, pasi nuk është deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën përkatëse të interesave, si dhe për shkak se buron nga pagesa e apartamentit, e cila nuk është kryer me të ardhura të krijuara nga burime të ligjshme nga personi i lidhur dhe prindërit e saj⁹.

(iii) Shkaku i ankimit, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me shpenzimet e mobilimit të dy apartamenteve të cilësuar më sipër në këtë

⁸ Paragrafët 12.1-12.45 të ankimit të Komisioneres Publike.

⁹ Paragrafët 13.1.-13.10 të ankimit të Komisioneres Publike.

vendim, vjen si rrjedhojë e vlerësimit që Komisionerja Publike i ka bërë gjendjes së likuiditeteve në *cash* të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, duke ngritur pretendime lidhur me burimet e ligjshme financiare për mbulimin e këtyre shpenzimeve¹⁰.

15.1. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se në ankimin e Komisioneres Publike nuk janë ngritur pretendime në formën e një dyshimi lidhur me besueshmërinë e:

- a) përfitimit të shumës prej 4.460.000 lekësh nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, si shumë e kthyer në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes së apartamentit në rrugën “{***}”, nga çmimi i paguar prej tyre për porositjen e kësaj pasurie;
- b) çmimit/vlerës së shitjes së apartamentit të sipërcituar, në vitin 2014, në shumën 130.000 euro.

Në vlerësim të trupit gjykues, Komisionerja Publike, në ankim, nuk ka ngritur dyshime për përfitime të jashtëzakonshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, që burojnë nga veprimet juridike të kryera prej tyre për shitblerjen e pasurisë “apartament”, në rrugën “{***}”, në Tiranë”. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se gjetja dhe opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar nuk gjen mbështetje në parimet dhe parashikimet e dispozitave që përbëjnë kornizën kushtetuese dhe ligjore të procesit të rivlerësimit dhe, më tej, të zhvillimit të këtij procesi në fazën e shqyrtimit gjyqësor në Kolegj¹¹.

Në mbështetje të parashikimeve të nenit B, pika 3, shkronja “b” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, ku cilësohet se “gjetja” përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, duket se “gjetja” përbën provën ose duhet të shoqërohet me provën përkatëse, e materializuar, reale dhe e dokumentuar, e cila kërkohet të merret në shqyrtim nga Kolegji. Në çështjen konkrete, “gjetja” ka ngritur dyshime bazuar në fakte të cilat burojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe të cilat janë përcjellë prej tij në Kolegj për efekt të shqyrtimit të ankimit të Komisioneres Publike, duke mos arritur në një konkluzion për ekzistencën e një fakti të ri. Përkundrazi, sipas gjetjes për të konkluduar për sa dyshohet lidhur me faktet e referuara në të, kërkohet që të ndërmerren disa veprime hetimore. Edhe e parë në këndvështrimin e barasvlefshmërisë së saj me mendimin e një eksperti, në vlerësimin e trupit gjykues, kjo gjetje nuk përmban një qëndrim të qartë, të konfirmuar dhe shterues, në interpretimin e akteve/fakteve të rezultuara nga hetimi i Komisionit, por vetëm ngre dyshime, të cilat kanë si

¹⁰ Paragrafët 14.1.-14.9 të ankimit të Komisioneres Publike.

¹¹ - Neni B, pika 3, shkronja “b” e Aneksit të Kushtetutës, përcakton se: “3. Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: [...] b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit Dh. Lidhur me këto gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojë që Komisioni ose Kolegji i Apelit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit; [...]”.

- Neni 49 i ligjit nr. 84/2016, në pikat 10 dhe 11 të tij parashikon se: “10. Gjetja, e paraqitur në formën e një deklaratë, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelit e çmon gjetjen si të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelit. 11. Një mendim me shkrim i dhënë nga vëzhguesit ndërkombëtarë konsiderohet një përfundim i dhënë për një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit ose që rezulton nga faktet në çështje të veçanta. Mendimi mund të ndikojë në vendimmarrjen e Komisionit ose të Kolegjit të Apelit, por nuk ka vlerën e provës”.

qëllim të justifikojnë nevojën për hetim të mëtejshëm, të fakteve që burojnë nga hetimi i zhvilluar në Komision. Në konkluzion, trupi gjykues çmoi se përmbajtja e gjetjes dhe kërkimi fundor në të, në lidhje me nevojën për hetime, nuk e kualifikojnë atë në përputhje me përcaktimin e nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, i cili e përkufizon gjetjen si provë në vetvete dhe jo si mjet për kërkimin e saj.

15.2. Në të njëjtin konkluzion, trupi gjykues arriti dhe për sa i përket opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar, i cili është paraqitur si rrjedhojë e gjetjes, pasi ky mendim i vëzhguesit ndërkombëtar paraqitet në formën e një kërkesë drejtuar trupit gjykues të Kolegjit, për kryerjen e veprimeve hetimore të identifikuar konkretisht, dhe jo si përfundim i dhënë për një rrethanë të rezultuar gjatë procesit të rivlerësimit ose që rezulton nga faktet në çështje të veçanta, ashtu siç përcaktohet në nenin 49, pika 11 e ligjit nr. 84/2016.

15.3. Trupi gjykues vëren se një kërkesë për marrje provash nga vëzhguesi ndërkombëtar është parashikuar në nenin 49, pika 12 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: *“12. Refuzimi i kërkesës së vëzhguesit ndërkombëtar për të marrë prova bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit, duke argumentuar shkaqet e refuzimit”*. Edhe në kuadër të këtij parashikimi ligjor, trupi gjykues konstatoi se nga përmbajtja e kërkesave për hetim të renditur në opinionin/mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar, faktet që pretendohen të hetohen kanë rezultuar nga hetimi administrativ i kryer në Komision dhe, si të tilla nuk përbëjnë fakte ose rrethana të reja që të përlligjin një veprimtari hetimore gjatë gjykimit në Kolegj.

Sipas përcaktimit të nenit B, pika 3, shkronja “b” e Aneksit të Kushtetutës, vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojë *që Kolegji të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit*, parashikim që nëpërmjet nënvizimit të togfjalëshit “sipas ligjit”, nënkupton se marrja në shqyrtim e provave në procesin gjyqësor të rivlerësimit kalimtar, nuk i referohet ngushtësisht përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, por në tërësi legjislacionit të zbatueshëm që rregullon veprimtarinë gjyqësore të Kolegjit, që përfshin parimet kushtetuese dhe konventore, ndër to edhe të procesit të rregullt ligjor dhe sigurisë juridike, si dhe legjislacionin e përcaktuar në nenin 4, pika 6 e këtij ligji dhe neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar, dispozita të cilat orientojnë Kolegjin në aplikimin e normave të Kodit të Procedurës Civile. Në kushtet kur gjykimi i çështjes në Kolegj është iniciuar nga ankimi i Komisioneres Publike, kufijtë e shqyrtimit të saj janë përcaktuar dhe limituar nga përmbajtja e shkaqeve të ankimit, për pasojë dhe gjetja apo mendimi i vëzhguesit ndërkombëtar, i paraqitur në çdo fazë procedurale të gjykimit të çështjes në Kolegj, duhet të bjerë brenda sferës së shkaqeve të ankimit duke mos i tejkaluar ato, përveç se kur është marrë dijeni për një fakt apo rrethanë pas depozitimit të ankimit në Kolegj, dhe ky nuk është rasti konkret, ashtu siç është analizuar më sipër në këtë vendim.

16. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se gjetja dhe opinionin i vëzhguesit ndërkombëtar është në tejkalim dhe jashtë shkaqeve të ankimit të Komisioneres Publike e, për rrjedhojë, në zbatim të parimit të sigurisë juridike, si dhe parashikimeve të neneve 6 dhe 465, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile, shqyrtimi i çështjes në Kolegj duhet të vijojë brenda kufijve të shqyrtimit të ankimit.

17. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues analizoi shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike, parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 689, datë 24.07.2023, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, si dhe parashtrimet e konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit¹², i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, duke analizuar e vlerësuar të gjitha provat që gjendeshin në dosjen e hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor në Kolegj dhe që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve.

B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

18. Shkaqet e ankimit të parashtruara prej Komisioneres Publike, në ankim, kundërshtojnë konkluzionet e arritura nga Komisioni për kriterin e kontrollit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Ato lidhen kryesisht me përfundimet e arritura mbi burimet e krijimit të pasurisë së paluajtshme “apartament me sipërfaqe 99,7 m², në rrugën “{***}”, Tiranë” (në vijim “apartamenti”), pasurisë së vetme të paluajtshme të regjistruar në regjistrat publikë në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për të cilën ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si vijon:

*“Kontratë përfundimtare shitblerje (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.07.2016, me palë shitëse shoqëria “{***}” ShPK dhe palë blerëse Ervin Pollozhani, A. P.. Vlera: 120.000 euro. Pjesa takuese: 50%+50% me bashkëshorten. Shuma 120.000 euro është likuiduar tërësisht, ku 108.000 euro janë paguar menjëherë më datë 22.09.2014 me lidhjen e kontratës, me anë të transfertës në llogarinë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK dhe 12.000 euro janë paguar më datë 02.03.2016 nga llogaria bankare e bashkëshortes, menjëherë me hartimin e procesverbalit të dorëzimit të apartamentit. Burimi i krijimit: nga shitblerja e apartamentit të mëparshëm”.*

18.1. Në vijim, në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar në mënyrë kronologjike, të gjitha veprimet juridike për blerjen e kësaj pasurie, si dhe të gjitha veprimet juridike që lidhen me blerjen dhe shitjen e apartamentit të mëparshëm me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}” në Tiranë, si dhe burimet e krijimit të kësaj pasurie, si vijon.

*Procesverbal dorëzim apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.03.2016, për palët: shoqëria “{***}” ShPK dhe Ervin Pollozhani, A. P., për dorëzimin e apartamentit të porositur me kontratën e shitblerjes paraprake nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2014. Shuma 12.000 euro (likuidim nga llogaria bankare e bashkëshortes e vlerës së mbetur pa likuiduar nga kontrata e shitblerjes paraprake [...]).*

*Kontratë shitblerje paraprake nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2014, me palë shoqëria “{***}” ShPK dhe palë blerëse Ervin Pollozhani, A. P.. Vlera: 120.000 euro. Pjesa takuese: 50%+50% me bashkëshorten. Shuma: 120.000 euro (108.000 euro të paguara menjëherë me*

¹² Bisedimet përfundimtare u zhvilluan në seancën gjyqësore të datës 25.11.2025.

*lidhjen e kontratës, me anë të trasfertës në llogarinë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK dhe 12.000 euro do të paguhen në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes).*

*Kontratë shitje apartamenti dhe mobilimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.2014, me palë shitëse Ervin e A. Pollozhani dhe palë blerëse A. dhe E. D., 130.000 euro të likuiduara menjëherë në llogarinë bankare të bashkëshortes në Credins Bank.*

*Kontratë shitblerje për pasuri të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2012, lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK - shitësi dhe A. e Ervin Pollozhani – blerësit (në mbështetje të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2007, të lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK - sipërmarrësi dhe bashkëshortja A. Ç. - porositësi, 11.700.000 lekë).*

*Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2012, e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, z. V. C., për kthimin e shumës së lekëve për shkak të moskryerjes së punimeve në objekt dhe mosdorëzimit në kohë të tij, si diferencë mes vlerës së kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2007, të lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK - sipërmarrësi dhe A. Ç. - porositësi dhe kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2012, të lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK - shitësi dhe A. e Ervin Pollozhani - blerësit, 4.446.000 lekë. Kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2007, të lidhur midis sipërmarrësit shoqëria “{***}” ShPK dhe porositëses A. Ç. për pasurinë apartament me sipërfaqe 117 m², në vlerën 117.000 euro (115.000 euro shlyer në momentin e lidhjes së kontratës dhe 2.000 euro do të shlyheshin me marrjen e apartamentit në dorëzim). Porositur ky apartament nga të ardhurat familjare të siguruara nga aktiviteti (biznesi) i tyre tregtar i filluar që nga viti 1995, fillimisht në emrin e bashkëshortes e më pas familjarëve të saj dhe të ardhurat personale të punës si mjeke e përgjithshme, mjeke promovimi.*

18.2. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e deklaruar si më sipër.

18.3. Në përfundim të verifikimit e kontrollit të kësaj pasurie, Komisioni, në vendim, ka arritur në konkluzionin¹³: [...] Pavarësisht se trupi gjykues vlerësoi në tërësi se personi i lidhur dhe familjarët e saj kanë pasur të ardhura të provuara në nivel të kënaqshëm ligjor për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer nga personi i lidhur në shtator të vitit 2007 për blerjen e apartamentit në Tiranë, në vlerësim të situatës faktike çmohet gjithësesi se problematikat e konstatuara në vlerësimin e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe se ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar, për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues është bazuar edhe në aplikimin e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë rrethanat e konstatuara të lidhura me pasuri të krijuar para martese në mungesë të kontributit financiar nga subjekti si dhe në mosevidentimin e ndonjë të dhëne tjetër për deklaram të rremë, fshehje pasurie, apo që të ardhurat e deklaruara për blerjen

¹³ Faqja 35 e vendimit të Komisionit.

e saj të jenë rrjedhojë e ndonjë veprimtarie të kundërligjshme – fakt që mund të cenonte pozitën e tij në këtë proces. Për sa u arsyetua më sipër, ligjshmëria e të ardhurave për pasurinë e krijuar para martese, analizuar në nivelin e provave dhe rrethanave specifike të rezultuara për këtë subjekt, vlerësohen nga trupi gjykues se nuk cenojnë qëllimin e ligjit që normon procesin e rivlerësimit kalimtar. Ky konkluzion i trupit gjykues, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit është në koherencë edhe me vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) për çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë” [...].

19. Komisionerja Publike, në ankimin e paraqitur në Kolegj, ka çmuar se nën dritën e dispozitave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, neneve 30 dhe 33, pika 5, shkronja “b” dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri është i pabazuar në ligj dhe në prova, pasi nga analiza e veprimeve juridike të kryera, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete, rezulton që shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe nuk arrijnë të provonin të kundërtën e barrës së provës, lidhur me mbulimin me të ardhura të ligjshme të pasurisë apartament, ndodhur në rrugën “{***}”, nga shitja e të cilit, të ardhurat e përfituara janë deklaruar si burim financiar krijimi për pasurinë objekt kontrolli “apartament me sipërfaqe 99,7 m², në rrugën “{***}”, Tiranë”.
20. Shkakun e ankimit sipërcituar, Komisionerja Publike e ka mbështetur në pretendime, të cilat u shqyrtuan dhe analizuan nga trupi gjykues si më poshtë.
21. Komisionerja Publike, në argumentimin e shkakut të ankimit, ka pretenduar se *faktet dhe rrethanat e rezultuara gjatë hetimit administrativ, që lidhen me periudhën e njohjes së subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten, kohën e zyrtarizimit të marrëdhënies së tyre, faktin se kontrata e shitblerjes së pasurisë apartament me sipërfaqe 99,17 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij dhe kjo pasuri është regjistruar në bashkëpronësi me pjesë takuese 50% secili, faktin që të ardhurat nga shitja kanë shërbyer si burimi kryesor i krijimit të pasurive të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur me të, lexuar në harmoni me deklaratimet e tyre në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratën e interesave private periodike të pasurisë dhe parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, përcaktojnë detyrimin e subjektit për justifikimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.*
 - 21.1. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura gjatë gjykimit në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisioneres Publike, si më sipër, ndërsa në konkluzionet përfundimtare pranoi se kjo pasuri është krijuar nga familja e personit të lidhur, znj. A. P. (Ç.), para lidhjes së martesës ligjore me subjektin e rivlerësimit¹⁴.
 - 21.2. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare mbajti të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke

¹⁴ Paragrafi 1.8.1. i konkluzioneve përfundimtare të parashtruara në Kolegj, nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në seancën gjyqësore të datës 25.11.2025.

argumentuar, në mënyrë të përmbledhur se ai dhe personi i lidhur janë njohur për herë të parë në fundvitin 2005. Për shkak se në atë periudhë ata jetonin dhe ushtronin veprimtarinë e tyre profesionale në qytete të ndryshme, frekuentimi i ndërsjellë ka qenë i kufizuar në kohë dhe tematika e bisedave mes tyre përfshirë edhe pas prezantimit formal me familjet përkatëse në mars 2007, nuk ka pasur të bëjë asnjëherë me diskutime mbi vendimmarrjet apo planet pasurore të prindërve të tyre. Megjithëse martesë është formalizuar me celebrim në korrik 2008, bashkëjetesa faktike ka filluar vetëm në muajin shtator të po këtij viti, kur bashkëshortja u emërua si mjekë pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në Tiranë dhe ata u vendosën në banesën e prindërve të subjektit të rivlerësimit, apartament në rrugën “{***}”, në Tiranë. Prej vitit 2014 e aktualisht, ata jetojnë së bashku me fëmijët në pasurinë objekt kontrolli, i cili është përftuar përmes një transaksioni blerjeje të realizuar në vitin 2014 me burim financiar kryesor të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 97,5 m² i ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë. Që në vitin 2000, me fillimin e studimeve universitare të bashkëshortes në fakultetin e mjekësisë, prindërit e saj kishin planifikuar sigurimin e një banese në qytetin e Tiranës, me qëllim krijimin e një baze të përhershme, jo vetëm për të, por edhe për fëmijët e tjerë që do të vazhdonin studimet në këtë qytet, duke ndërmarrë kërkime të zgjatura në zona të ndryshme të Tiranës dhe zhvilluar negociata me subjekte ndërtuese, të cilat kulmuan me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes, më datë 18.09.2007, ndërmjet znj. A. Ç. dhe shoqërisë ndërtimore “{***}” ShPK, për ndërtimin e apartamentit në rrugën “{***}”, në Tiranë. Zgjedhja e Komisioneres Publike për të trajtuar vitin 2005 si moment themelor për fillimin e një marrëdhënieje me implikime ekonomike, në vend që të mbështetet në faktin e deklaruar të fejesës në mars 2007 dhe të mosfillimit të bashkëjetesës deri në shtator 2008, çon në një vlerësim të gabuar dhe të deformuar të realitetit faktik dhe ekonomik që duhej analizuar. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga personi i lidhur, konform kërkesave ligjore, në deklaratën e interesave të vitit 2008, ndërsa një shpjegim i detajuar lidhur me rrethanat konkrete të porositjes së apartamentit, si dhe burimeve financiare të përdorura për këtë qëllim, janë dhënë prej saj pranë ILDKPKI-së, që në vitin 2014, në një kohë ndjeshëm të hershme në raport me nisjen e procesit të rivlerësimit kalimtar.

Sipas subjektit të rivlerësimit, nga Komisionerja Publike nuk është ndërmarrë një shqyrtim kronologjik dhe i integruar i zhvillimeve faktike që lidhen me procesin e porositjes së apartamentit, deklarin pranë ILDKPKI-së dhe aktin e blerjes së pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se adresa e re e banimit në rrugën “{***}” është përfshirë si adresë sekondare për herë të parë në deklarin pasues atë të vitit 2010, e më pas edhe në deklarinimet e viteve 2011, 2012 dhe 2013, në përputhje me ndryshimin e vendbanimit faktik, duke ruajtur si adresë primare, atë të regjistrimit në gjendjen civile, apartamentit në rrugën “{***}”. Nga të gjitha aktet e dokumentet zyrtare të administruara rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i përfshirë në asnjë marrëdhënie sipërmarrje kontraktuale, sipërmarrje, garancie, apo dorëzanie në lidhje me pasurinë “apartament, me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë”, që të sjellë përgjegjësi pasurore apo tatimore. Në këto kushte, sipas subjektit të rivlerësimit, çdo vendimmarrje që synon ta ngarkoj atë me përgjegjësi për mosjustifikim të burimeve të një pasurie të financuar në mënyrë të pavarur nga persona të tretë, për më tepër përpara fillimit të regjimit martesor, do të binte në kundërshtim me standardin e vlerësimit të konsoliduar në vendimmarrjet e mëparshme të Kolegjit. Barra e provës

përfaqëson një investim, i cili në aspektin juridik dhe ekonomik mbështetet në një pasuri të përjashtuar nga regjimi i bashkëpronësisë bashkëshortore, sipas parashikimeve të Kodit të Familjes dhe nuk mund të ngarkojë subjektin e rivlerësimit me provimin e burimeve financiare për aq kohë sa nuk provohet ndonjë përfshirje ose bashkëfinancim nga ana e tij dhe për aq kohë sa personi i lidhur dhe as familjarët e saj, në kohën e krijimit të pasurisë apartament në rrugën “{***}”, nuk ishin subjekte deklarimi dhe nuk përbënin persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Pjesa takuese e barabartë prej 50% në pronësi me personin e lidhur në këtë pasuri, e vendosur në kontratën përfundimtare të shitblerjes, është bërë për qëllim të formalizimit të titullit të pronësisë, në përputhje me faktin se subjekti i rivlerësimit figuronte si bashkëpronar për shkak të statusit “i martuar” me pronaren *de facto* të kësaj pasurie, por kjo nuk implikon automatikisht bashkëinvestim në të njëjtën masë financiare. Kjo e dhënë nuk mund të lexohet nga Komisionerja Publike e shkëputur nga pjesa tjetër e deklaratës në të cilën qartësisht është deklaruar burimi i krijimit të pasurisë që rezulton të jetë ekskluzivisht nga të ardhurat e bashkëshortës dhe prindërve të saj. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, e cila ka sanksionuar se një pasuri e krijuar nga një person i lidhur para lidhjes së martesës ligjore me subjektin e rivlerësimit, nuk mund të konsiderohet automatikisht si pasuri e përbashkët apo si burim që ngarkon subjektin me detyrime sqaruese apo provuese, në mungesë të një marrëdhënieje konkrete ekonomike të ndërsjellë. Për pasojë, çdo konkluzion që përpiqet të identifikojë përfshirjen financiare të subjektit të rivlerësimit mbi bazën e një regjistrimi formal të pronësisë pa marrë parasysh burimin real të financimit dhe rrethanat specifike të kontratës, do të ishte i pabazuar në ligj dhe në faktet objektive të administruara në këtë proces.

Trupi gjykues konstatoi se përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, mbështetur në shkaqet e ankimit, në përfundim të hetimit gjyqësor, e pasi analizoi provat e paraqitura, ka vlerësuar se pasuria “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}” në Tiranë”, është krijuar nga familja e personit të lidhur, znj. A. P. (Ç.), para lidhjes së martesës ligjore me subjektin e rivlerësimit dhe, për pasojë, problematikat që lidhen me të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e saj, të vetme, nuk konsiderohen të mjaftueshme si shkaqe objektive dhe proporcionale për të ngarkuar subjektin e rivlerësimit me masë disiplinore, por duhen vlerësuar nga Kolegji në kuadër të një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të pasurisë. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i Komisioneres Publike, sipas paragrafit 21 më sipër në këtë vendim, nuk duhet të jetë pjesë e vlerësimit, duke u konsideruar i shëruar në gjykimin në Kolegji, për sa kohë që përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme arriti në konkluzionin se pasuria objekt kontrolli është krijuar para lidhjes së martesës ligjore të subjektit të rivlerësimit me znj. A. P. (Ç.).

22. Sa i përket pretendimit të Komisioneres Publike se ***të ardhurat që kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë “apartament, me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, Tiranë”, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, mbesin në nivel deklarativ dhe nuk provohet ligjshmëria e tyre***, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si më poshtë.

22.1. Komisioni, në vendim, për kontrollin e burimeve financiare për blerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë”, i ka nënshtruar analizës të gjitha burimet e

deklaruara prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe ato të deklaruara prej tij gjatë hetimit administrativ, konkretisht: të ardhurat e krijuara nga aktiviteti tregtar i familjes së bashkëshortes; të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja nga puna si përkthuese; si dhe të ardhurat e bashkëshortes si mjeke e përgjithshme dhe si mjeke promocioni. Në përfundim të kësaj analize¹⁵, Komisioni ka konkluduar se: [...] *subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm, në përmbushje të kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, përfitimin e të ardhurave nga personi i lidhur dhe familjarët e saj deri në shtator të vitit 2007, në total në shumën rreth 15 milionë lekë. Si rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se personi i lidhur dhe prindërit e saj kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të provuara në nivel ligjor, të cilat kanë mundësuar plotësisht pagesën e shumës 115.000 euro në shtator të vitit 2007 (konvertuar në atë periudhë në shumën prej rreth 14.000.000 lekësh). Ky konkluzion vjen në përputhje me qëndrimin e konsoliduar të mbajtur nga Kolegji në rastet e kërkesës së provueshmërisë së të ardhurave për dhurimet apo huatë nga personat e tjerë të lidhur, duke çmuar se edhe në këtë rast është më se e mjaftueshme provueshmëria e përfitimit të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në shtator të vitit 2007, duke supozuar se nga tërësia e të ardhurave të pretenduara, të ardhurat e tjera të referuara si të përfituara nga aktiviteti i ligjshëm, por të paprovuara plotësisht me dokumentacion justifikues ligjor (të ardhurat shitesë nga aktiviteti tregtar, ku përfshihet edhe ai i bimëve medicinale), mund të kenë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të tjera të familjes Ç., duke mos cenuar në vetvete ligjshmërinë e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën në fjalë.*

22.2. Komisionerja Publike, referuar arsyetimit dhe analizës si më sipër, të kryer nga Komisioni, ka kundërshtuar vlerat e konkluduara prej këtij të fundit se përfaqësojnë të ardhurat e personit të lidhur dhe prindërve të saj, të cilat kanë shërbyer si burim kryesor për financimin e çmimit të blerjes së pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë” (në vijim “pasuria apartament me sipërfaqe 97,5 m²”), duke pretenduar se nuk janë vlerësuar drejtë provat që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur për të justifikuar këto të ardhura.

22.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisioneres Publike në ankim, duke pretenduar se të ardhurat që kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë “apartament me sipërfaqe 97,5 m²”, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, mbesin në nivel deklarativ dhe nuk provohet ligjshmëria e tyre. Në konkluzionet përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerësoi se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me të ardhurat e familjes Ç., të deklaruara si burim krijimi për pasurinë objekt kontrolli, të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë “apartament me sipërfaqe 99,7 m², në rrugën “{***}”, Tiranë”. Në kushtet kur problematikat e mësipërme lidhen me të ardhurat të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m²” të personit të lidhur, krijuar para martesës ligjore me subjektin e rivlerësimit, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerësoi se këto mangësi të

¹⁵ Faqja 34 e vendimit të Komisionit.

vetme nuk konsiderohen të mjaftueshme si shkaqe objektive dhe proporcionale për të ngarkuar drejtpërdrejt subjektin e rivlerësimit me masë disiplinore, por duhen vlerësuar nga Kolegji në kuadër të një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë.

22.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, në prapësimin e shkakut të ankimit, mbajti qëndrim të njëjtë me atë gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar se ka bërë çdo përpjekje të arsyeshme dhe të domosdoshme për të përmbushur detyrimin ligjor për justifikimin e këtyre të ardhurave në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, duke paraqitur një paketë të plotë provash dokumentare. Sipas subjektit të rivlerësimit, pamundësia objektive, në përputhje me parashikimet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të siguruar dokumentacionin e plotë për të gjitha të ardhurat për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, të mungesës së arkivimit elektronik të detajuar për ato periudha apo edhe për shkaqe objektive të humbjes së të dhënave, nuk mund të përkthehet në mënyrë automatike si mungesë e të ardhurave apo si përjashtim i ligjshmërisë së tyre, për atë kohë sa ekziston një strukturë provuese e besueshme dhe një linjë deklarimi e qëndrueshme. Nisur nga këto rrethana dhe duke marrë në konsideratë parimin e proporcionalitetit dhe të ndarjes së barrës së provës në mënyrë të arsyeshme, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit që vlerësimi i këtyre të ardhurave të bëhet në një standard të diferencuar provueshmërie, duke u kufizuar jo vetëm në formën, por në përmbajtjen dhe besueshmërinë e tyre, si dhe në burimin real prej nga janë krijuar.

- 23.** Analiza e mëtejshme e trupit gjykues vijoi me shqyrtimin e pretendimeve të Komisioneres Publike, në ankim, lidhur me të ardhurat e personit të lidhur, znj. A. Ç. dhe prindërve të saj, të cilat sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit kanë shërbyer si burim financiar për blerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë”, si më poshtë.
- 24.** Lidhur me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i familjes Ç., Komisionerja Publike ka pretenduar, në ankim, se ato nuk duhen përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të familjes Ç., për krijimin e pasurisë objekt kontrolli.

24.1. Komisioni, në vendim¹⁶, ka arsyetuar se: [...] *Pas analizimit në tërësi të provave të administruara në harmoni me deklaratimet e bëra në vazhdimësi nga subjekti dhe personi i lidhur, trupi gjykues krijoi bindjen se edhe për periudhën janar 1998 - mars 2002, në njësinë e shërbimit në pronësi të familjes Ç. është ushtruar aktivitet tregtar dhe, si rrjedhojë, janë përfutuar të ardhura nga ky aktivitet. Kështu, rezulton e provuar se tatimpaguesi “A. Ç.”, Person Fizik, ka paguar taksat/tarifat vendore pranë Bashkisë Bajram Curri, sot Bashkia Tropojë, nga viti 1996 deri në vitin 2002. Në këtë optikë, Komisioni vlerëson përpjekjen e vazhdueshme të subjektit të rivlerësimit për të disponuar nga institucionet përkatëse dokumentacion ligjor mbi ushtrimin e aktivitetit tregtar nga ana e personit të lidhur dhe familjarëve e saj, duke çmuar se edhe pse ka provuar se ky aktivitet është ushtruar edhe për periudhën janar 1998 - mars 2002, ai ka qenë në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion të plotë ligjor provues për qarkullimin e realizuar,*

¹⁶ Faqja 30 e vendimit të Komisionit.

fitimin neto, si dhe për pagesën e detyrimeve tatimore krahas dokumentimit të pagesës së taksave/tarifave vendore për të ardhurat e përfituara për këtë periudhë, duke u gjendur në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, trupi gjykues çmon se mosparaqitja e dokumenteve të plota për këtë periudhë është për shkaqe të arsyeshme, marrë në konsideratë këtu realitetin social-ekonomik të kohës, duke sjellë në vëmendje trazirat e vitit 1997 dhe luftën e Kosovës, të nisur në fillim të vitit 1998, fakte këto të njohura botërisht, të cilat kanë sjellë si pasojë mosfunksionimin normal të institucioneve shtetërore të administratës qendrore dhe lokale në një vend kufitar si Tropoja. Për sa më sipër, në mungesë të informacionit dhe dokumentacionit mbi qarkullimin e realizuar si rrjedhojë e ushtrimit të aktivitetit tregtar për periudhën janar 1998 - mars 2002, në një vlerësim alternativ dhe objektiv, Komisioni vendosi që për efekt analize është realizuar qarkullimi vjetor prej 2 milionë lekësh, i cili i përgjigjet fashës së qarkullimit të përcaktuar në ato vite për biznesin e vogël. Pra, vlerësohet se subjekti tregtar “A. Ç.”, Person Fizik, për periudhën janar 1998-mars 2002 ka realizuar qarkullimin total në shumën 8.500.000 lekë. Sjellim në vëmendje këtu se në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, por edhe në prapësimet e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar një normë më të lartë fitimi për këtë periudhë nga ajo sa ka vlerësuar Komisioni, duke referuar se fluksi i punës ka qenë më i madh për shkak të ardhjes së një numri të konsiderueshëm të refugjatëve nga Kosova, çka solli rritje të lëvizjeve të njerëzve në rrethin e Tropojës dhe, si rrjedhim, rritje të qarkullimit, të çmimeve dhe të normës së fitimit. Por, trupi gjykues vlerëson të aplikojë të njëjtën normë fitimi, të vlerësuar paraprakisht për periudhat e tjera objekt analize, duke pranuar për efekt analize si të ardhura neto të realizuara nga aktiviteti tregtar për këtë periudhë shumën 3.825.000 lekë.

24.2. Komisionerja Publike, në ankim, në kundërshtimin e vlerësimit të mësipërm të Komisionit, ka argumentuar se të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti tregtar i familjes Ç., për periudhën 1998-2002, në shumën 3.825.000 lekë, nuk duhen përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të familjes Ç., pasi:

(i) bazuar në aktet e administruara nga Komisioni rezulton se për periudhën 1998 - mars 2002, nuk konfirmohet nga organet tatimore ushtrimi i aktivitetit tregtar dhe si rezultat nuk konfirmohen të ardhura të realizuara në këtë periudhë. Vetë subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar në aktin “Relacion shpjegues” dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 21.11.2014, se pas viteve 1997, formalisht, janë ndërprerë marrëdhëniet institucionale me degën e tatim-taksave Tropojë;

(ii) nuk qëndron as pretendimi i subjektit të rivlerësimit, mbi pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion provues, për të treguar ligjshmërinë e të ardhurave të familjes së origjinës së bashkëshortes së tij, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti nuk solli ndonjë dokument mbështetës, që të justifikonte ekzistencën e një pamundësie objektive apo të provonte se dokumenti nuk gjendet, është dëmtuar apo zhdukur.

24.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime konfirmoi qëndrimin e Komisioneres Publike, në ankim, ndërsa në konkluzionet përfundimtare mbajti qëndrimin e pasqyruar në paragrafin 22.3 më sipër në këtë vendim.

24.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare pretendoi se fitimi *neto* i realizuar nga znj. A. Ç. dhe prindërit e saj nga aktiviteti tregtar, gjatë periudhës kohore 1995-2007, ka qenë për afërsisht në shumën 12.300.000 lekë, një shumë proporcionale me kohëzgjatjen e këtij aktiviteti prej 11 vjetësh dhe ushtrimit të tij në kushte lokale dhe familjare. Sipas subjektit të rivlerësimit, pretendimi i Komisioneres Publike për mosllogaritje të të ardhurave për periudhën 1998-mars 2002 nuk qëndron, pasi kjo periudhë përkon me: (i) mosfunksionimin e institucioneve shtetërore për shkak të trazirave të vitit 1997 e në vijim, përfshirë edhe mungesën ose funksionimin minimal të strukturave tatimore në rrethin e Tropojës, fakt i njohur botërisht; (ii) një periudhë intensifikimi të aktivitetit tregtar në këtë rajon, për shkak të situatës gjeopolitike dhe humanitare të shkaktuar nga lufta në Kosovë (1998-2000), e cila solli lëvizje të mëdha popullore në atë zonë kufitare.

Shpjegimi i dhënë prej tij në relacionin drejtuar ILDKPKI-së në vitet 2014 dhe 2017, se *pas viteve 1997, formalisht janë ndërprerë marrëdhëniet institucionale me degën e tatim-taksave Tropojë*, është nxjerrë jashtë kontekstit nga Komisionerja Publike, pasi shpjegimi i mësipërm është bërë në kushtet kur nga dosja fizike e siguruar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës, Agjencia Tatimore Tropojë ka rezultuar se kanë munguar formalisht deklaratimet e bëra nga subjekti tregtar për formularin e xhiros vjetore të parashikuar për efekt të qarkullimit vjetor apo edhe të pagës së deklaruar si i vetëpunësuar, por kurrsesi nuk ka qenë kuptimi që nuk ka pasur marrëdhënie me këtë institucion. Ky qëndrim vjen edhe si pasojë e të dhënave që rezultojnë nga aktet e DRT-së Kukës dhe Bashkisë Tropojë, sipas së cilave subjekti tregtar “A. Ç.”, Person Fizik, ka përmbushur të gjitha detyrimet tatimore. Duke u mbështetur në standardin minimal të xhiros së regjistruar për bizneset e vogla të asaj kohe dhe në mungesë të dokumentacionit të detajuar për çdo vit kalendarik, është e arsyeshme që për çdo vit të merret parasysh një xhiro minimale prej 2.000.000 lekësh, duke përfshirë minimalisht 4 vite të dokumentuara si periudhë bazë, për të cilën ka pasur një regjistrim aktiv të subjektit tregtar, për një qarkullim total prej 8.000.000 lekësh, që përbën një bazë të arsyeshme për vlerësim të të ardhurave *neto* përkatëse.

25. Nga aktet e administruara nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se:

25.1. Në relacionin shpjegues që shoqëron deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur ka deklaruar se: [...] *Ndërkohë që pas viteve 1997, referuar trazirave të kohës, formalisht janë ndërprerë të gjitha marrëdhëniet institucionale tonat me degën e Tatim Taksave Tropojë, por kurrsesi nuk është ndërprerë biznesi ynë.* Të njëjtin deklaram, subjekti i rivlerësimit e ka bërë edhe pranë ILDKPKI-së, referuar “Procesverbalit mbi shpjegimet e subjektit deklarues”, të mbajtur në datën 21.11.2014.

25.2. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *A. Ç. ka filluar aktivitetin privat në dhjetor 1995 deri në mars 2002 [...]. Në vitet 1998-1999-*

2000 pati një rritje të konsiderueshme të xhiros për shkak të rritjes jo vetëm të numrit të klientëve, por edhe të rritjes së çmimeve të shitjes së mallrave. Në këtë periudhë fitimi shkonte dhe 50-60% të xhiros (presumuar xhiroja minimale 2.000.000 lekë në vit).

25.3. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...] Vlen të përmendet këtu se me trazirat e vitit 1997, sikurse në të gjithë vendin edhe në rrethin e Tropojës pjesa më e madhe e institucioneve pushoi së funksionuari apo kanë qenë në nivel minimal të operacionalitetit funksionues. Nga ana tjetër vërej se Komisioni nuk ka përllogaritur të ardhura nga ky aktivitet për vitet 1998 - 2001, vite në të cilat familja Ç. ka vijuar ushtrimin e aktivitetit tregtar, madje me intesitet më të lartë, kjo edhe për shkak të situatës së krijuar nga lufta e Kosovës dhe lëvizjet e shumta të njerëzve (vendas dhe të huaj) në rrethin e Tropojës. [...] Nisur nga rrethanat e mësipërme, si edhe në konsideratë të faktit të provuar mbi pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit të plotë, duke u gjendur në kushtet e nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, kërkoj që minimalisht të vlerësohet se për secilin vit ky subjekt tregtar ka realizuar qarkullimin minimalisht në shumën prej 2 milion lekë (fasha e biznesit të vogël), në total qarkullimin prej 8 milion lekë. [...] Sa më sipër, vihet re se periudha 01.01.1998 - 15.03.2002 nuk është konsideruar “fiskale”, pra nuk është konsideruar si një periudhë as me aktivitet tregtar dhe për rrjedhojë as me të ardhura. [...] nuk ekziston asnjë vendim gjykate për çregjistrimin e “A. Ç.”, si subjekt tregtar apo kërkesë pranë organeve tatimore për çregjistrimin e saj apo pezullimin e aktivitetit. Përpos kësaj, në kuadër të përpjekjeve për të siguruar prova shitesë, del e vërtetuar dhe me shkresën nr. {***} prot., datë 04.07.2023, të Bashkisë Tropojë. Gjithashtu, vijueshmërinë e veprimtarisë tregtare në këtë njësi e vërtetojnë dhe shkresat: nr. {***} prot., datë 03.07.2023 e lëshuar nga KESh ShA, me lëndë: Kthim përgjigje ndaj kërkesës për informacion, dhe vërtetimi i debisë nr. {***} prot., datë 04.07.2023, lëshuar nga FShU. Me këto shkresa evidentohet që njësia me kontratë në emër të I. Ç., nr. {***}, lagjja “{***}” ka pasur konsum të energjisë elektrike në mënyrë të pandërprerë që nga fillimi i vënies në shfrytëzim e në vijim deri në vitin 2023, ku brenda kësaj periudhe janë dhe vitet 1998-2002. Sa më sipër, për aktivitetin e personit fizik “A. Ç.” duhet konsideruar “fiskale” dhe duhen llogaritur të ardhura, periudha nga data 01.01.1998 - 15.03.2002, periudhë kjo, e cila ka pasur dhe fitimin më të madh.

26. Në analizë të shkakut të ankimit, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, vërehet se kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit, i cili ka konsideruar për efekt analize si të ardhura *neto* të realizuara nga aktiviteti tregtar i Personit Fizik “A. Ç.” për periudhën 1998-mars 2002, shumën 3.825.000 lekë, Komisionerja Publike e ka mbështetur në pretendimin se në aktet e administruara në dosje rezulton se për periudhën në fjalë, nuk konfirmohet nga organet tatimore ushtrimi i aktivitetit tregtar dhe si rezultat nuk konfirmohen të ardhura të realizuara në këtë periudhë.

Në mbështetje të dokumentacionit të administruar nga Komisioni, me fokus periudhën 1998-mars 2002, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur: deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI në datën 21.11.2014, pyetësorëve, si dhe shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se vërtetohet situata faktike si më poshtë.

26.1. Sipas të dhënave të vërtetimit nr. {***} prot., datë 14.10.2014, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës, Agjencia Tatimore Tropojë, me vendimin nr. {***}, datë 28.12.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, A. Ç. është regjistruar si Person Fizik, në njësi me artikuj të ndryshëm industrialë dhe ushqimorë dhe për të është lëshuar certifikata për regjistrimin në organin tatimor si person fizik, pajisur me kodin fiskal nr. {***} dhe nr. serial {***}, lëshuar nga Dega e Tatimeve dhe Taksave Tropojë.

26.2. Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 13.11.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës, bazuar në të dhënat e arkivit të Agjencisë Tatimore Tropojë, Personi Fizik “A. Ç.” ka përmbushur konform ligjit të gjitha detyrimet tatimore për të gjitha periudhat tatimore, rezulton të jetë subjekt aktiv dhe në asnjë prej periudhave nuk ka deklaruar pezullim aktiviteti apo humbje.

26.3. Me shkresën nr. {***} prot., datë 05.07.2017, Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës ka informuar ILDKPKI-në se nga të dhënat që disponon Agjencia Tatimore Tropojë rezulton se A. Ç. ka qenë e regjistruar si Person Fizik me kod fiskal nr. {***}.

26.4. Sipas përmbajtjes së vërtetimit nr. {***} prot., datë 04.07.2023, të lëshuar nga Bashkia Tropojë, nga dokumentacioni që ndodhet në Arkivin e Bashkisë Tropojë, vërtetohet se subjekti tregtar “A. Ç.” Person Fizik, i regjistruar me vendimin nr. {***}, datë 28.12.1995, të Gjykatës së Rrethit Tropojë, me objekt të veprimtarisë në fushën e tregtimit të artikujve të ndryshëm ushqimorë dhe industrialë, e regjistruar në organet tatimore me kod fiskal nr. {***} dhe numër serial {***}, datë 15.02.1996 dhe të ushtruar në njësinë tregtare në lagjen “{***}”, me nr. {***} pasurie, ka paguar taksat/tarifat vendore pranë Bashkisë Bajram Curri, sot Bashkia Tropojë, nga viti 1996 deri në vitin 2002. Nga viti 2002 e në vijim, për këtë njësi, taksat/tarifat vendore janë paguar nga subjektet tregtare “S. Ç.” Person Fizik me NIPT {***} dhe nga subjekti “I. Ç.” Person Fizik me NIPT {***}.

26.5. Shoqëria “KESH” ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 03.07.2023, ka informuar subjektin e rivlerësimit se kontrata e energjisë elektrike me nr. {***} figuron në emër të abonentit z. I. Ç., me adresë: lagjja “{***}”, Tropojë dhe nuk rezulton me status debitor deri më datë 31.12.2006.

26.6. Furnizuesi i Shpërndarjes Universale, OShEE Group, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.07.2023, ka vërtetuar se nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit, kontratat me kod {***}, titullar i të cilave është I. Ç. rezulton të kenë në total 0 (zero) lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike.

27. Nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i analizuar si më sipër, trupi gjykues konstatoi se organet tatimore rajonale, ku është regjistruar “A. Ç.” Person Fizik, që në datën 28.12.1995, jo vetëm kanë konfirmuar ushtrimin e aktivitetit prej këtij subjekti tregtar në mënyrë konstante dhe të qëndrueshme, por kanë vërtetuar se ky subjekt ka përmbushur konform ligjit të gjitha detyrimet tatimore, për të gjitha periudhat tatimore, si dhe rezulton të jetë subjekt tregtar aktiv dhe në asnjë prej periudhave nuk ka deklaruar pezullim aktiviteti apo humbje. Në të njëjtën linjë me organet tatimore rajonale, edhe autoriteti i pushtetit vendor, Bashkia Tropojë ka vërtetuar se nga ky subjekt

tregtar janë paguar taksat dhe tarifata vendore nga viti 1996 deri në vitin 2002, të cilat më pas kanë vijuar të paguhen nga subjektet tregtare “S. Ç.” Person Fizik dhe “I. Ç.” Person Fizik, që kanë vijuar me ushtrimin e aktivitetit në të njëjtën njësi tregtare. Edhe vetë personi i lidhur, znj. A. P. (Ç.), në “Relacionin shpjegues”, të paraqitur së bashku me deklaratën e rivlerësimit, ka konfirmuar se aktiviteti tregtar nuk është ndërprerë kurrësi. Znj. P. ka deklaruar, konkretisht se: [...] *historiku i biznesit tonë familjar daton që nga viti 1995 vazhdon edhe sot e kësaj dite, pra, gati 21 vjet biznes efektiv dhe tepër i suksesshëm. [...] Që në fillim të aktivitetit kam qenë subjekti i rregullt tatimor, fakt që provohet me provat bashkëlidhur, duke shlyer të gjitha detyrimet fiskale, sipas kuadrit ligjor të kohës. Kjo gjë përgjatë viteve 1996, 1997, provohet si e tillë edhe formalisht me aktet e dorëzuara. [...] Ndërkohë që pas viteve 1997, referuar trazirave të kohës, formalisht janë ndërprerë të gjitha marrëdhëniet institucionale tonat me degën e Tatim Taksave Tropojë, por kurrësi nuk është ndërprerë biznesi ynë. Kjo për faktin e vetëm se dihet botërisht se në atë kohë shteti nuk funksiononte efektivisht në asnjë lloj koncepti të tij dhe ku institucionet tatimore ishin paralizuar. Krahas kësaj aktiviteti i biznesit tonë ka vazhduar rregullisht, ku theksoj se që nga viti 1998 e më tej, ato kanë qenë vitet më të suksesshme të biznesit tonë. [...] Në këto vite 1998-2000, kemi pasur burimin më të madh të të ardhurave tona. [...] Pas kësaj në fundvitin 1999 kam fituar të drejtën e studimit në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, ndërkohë që biznesi familjar përsëri ka vazhduar aktivitetin e tij të rregullt me të njëjtin ritëm nga familjarët e mi (prindërit). [...] Kështu provohet se biznesi familjar në emër të nënës sime, S. Ç., e cila si e tillë ka bërë regjistrimin e saj pranë organeve tatimore në mars 2002. Vlen të theksohet se në këtë periudhë e në vijimësi, me forcimin e shtetit gjithçka në aspektin formal ka qenë e dokumentuar në lidhje me aktivitetin e biznesit tonë.*

27.1. Situata faktike e pasqyruar më sipër, sipas së cilës subjekti tregtar “A. Ç.”, Person Fizik, ka ushtruar aktivitet tregtar për të cilin ka përmblusur konform ligjit të gjitha detyrimet tatimore, për të gjitha periudhat tatimore, e interpretuar në harmoni me deklaratimet e sipërcituara të personit të lidhur, në vlerësim të trupit gjykues dëshmon një qëndrim të ndryshëm nga ai i pretenduar prej Komisioneres Publike. Logjikshëm, znj. A. P. (Ç.) dhe subjekti i rivlerësimit kanë qenë në dijeni të përmbajtjes së dokumentacionit të sipërcituar, pasi jo vetëm është një dokumentacion i lëshuar nga organet shtetërore me kërkesë të vetë personit të lidhur, por për të njëjtat fakte, janë dhënë deklarime prej tyre edhe më parë në ILDKPKI më datë 21.11.2014 dhe është paraqitur i njëjti dokumentacion. Edhe nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision është potencuar fakti se subjekti tregtar “A. Ç.” Person Fizik ka qenë i regjistruar në organet tatimore dhe ka qenë i pajisur me kod fiskal, për periudhën dhjetor 1995-mars 2002¹⁷. Madje, nga provat e paraqitura prej tij rezulton se për periudhën e kontestuar nga Komisionerja Publike si periudhë për të cilën nuk konfirmohet nga organet tatimore ushtrimi i aktivitetit tregtar, Bashkia Tropojë ka vërtetuar se *subjekti tregtar “A. Ç.” person fizik ka paguar taksat/tarifata vendore pranë bashkisë nga viti 1996 deri në vitin 2002.*

27.2. Në këtë analizë, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktin e provuar gjatë hetimit

¹⁷ Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit mbi pyetëtorin nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, faqe 11.

administrativ në Komision se familja e personit të lidhur, që në momentet e fillimit të ushtrimit të aktivitetit tregtar e në vijim ka pasur një qasje pozitive për ta ushtruar këtë aktivitet në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse: (i) njësia e shërbimit ku është ushtruar aktiviteti është ndërtuar në përputhje me lejen e ndërtimit për shtesë anësore pallati, miratuar në emër të investitorit I. Ç., me vendimin nr. {***}, datë 26.05.1994, të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Rrethit Tropojë; (ii) aktiviteti tregtar, në vijim, i ushtruar nga “S. Ç.” Person Fizik dhe “I. Ç.” Person Fizik, i regjistruar në organet tatimore është ushtruar në përputhje të plotë me legjislacionin fiskal në shlyerje të detyrimeve tatimore; (iii) z. I. Ç. nuk rezultoi debitor në pagesat e energjisë elektrike të njësisë së shërbimit të regjistruar në emër të tij, në të cilën është zhvilluar në vijimësi aktiviteti tregtar i familjes Ç..

27.3. Në këtë kontekst rrethanash faktike, kur rezultoi e provuar me dokumentacion të lëshuar nga organet tatimore, ushtrimi i aktivitetit tregtar nga “A. Ç.” Person Fizik edhe për periudhën 1998-mars 2002, por nga informacioni i përcjellë nga këto organe nuk evidentohet masa e qarkullimit të realizuar, masa e detyrimeve tatimore të paguara dhe, për rrjedhojë, as fitimi *neto* i realizuar nga ky subjekt tregtar. Trupi gjykues e gjeti të drejtë vlerësimin e Komisionit, i cili për efekt analize, për periudhën janar 1998 - mars 2002, ka konsideruar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, duke përlogaritur qarkullimin vjetor prej 2.000.000 lekësh, që i përgjigjet fashës së qarkullimit të përcaktuar në ato vite për biznesin e vogël dhe, për rrjedhojë, qarkullimin total të aktivitetit tregtar në shumën 8.500.000 lekë. Pas aplikimit të normës së fitimit prej 45%, të vlerësuar paraprakisht edhe për periudhat e tjera objekt analize¹⁸, Komisioni ka vlerësuar se e ardhura *neto* e realizuara nga aktiviteti tregtar për këtë periudhë nga “A. Ç.” Personi Fizik është në shumën 3.825.000 lekë. Ky qëndrim mbështetet në rrethanat specifike të rastit të analizuara gjerësisht më sipër, por edhe në jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës, në raste të ngjashme, kur nga organet tatimore është konfirmuar pagesa e detyrimeve tatimore, por jo masa e tyre dhe/ose as vlera e qarkullimit të realizuar e për pasojë as fitimi i realizuar nga aktiviteti tregtar i ushtruar prej subjekteve të rivlerësimit, personave të lidhur ose personave të tjerë të lidhur, e ardhura e realizuar është përlogaritur duke aplikuar një normë fitimi në konsideratë të rrethanave përkatëse në të cilat është ushtruar ky aktivitet¹⁹.

27.4. Qëndrimi i Komisioneres Publike se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi pamundësinë objektive për të siguruar dokumentacion provues për të treguar ligjshmërinë e të ardhurave të familjes së origjinës së bashkëshortes së tij, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, u gjet i drejtë nga trupi gjykues. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ashtu si edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka pretenduar aplikimin e nenit të sipërcituar, për sa i përket pamundësisë për të paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor për të ardhurat e personit të lidhur dhe familjes së saj për periudhën 1998-mars 2002, duke sjellë në vëmendje se nga trazirat e vitit 1997, sikurse në të gjithë vendin edhe në rrethin e Tropojës, pjesa më e madhe e institucioneve pushoi së funksionuari apo kanë qenë në nivel minimal të operacionalitetit funksionues.

¹⁸ Footnote 56, faqja 30 e vendimit të Komisionit.

¹⁹ Vendimet e Kolegjit nr. 29/2022 (JR); nr. 20/2023 (JR), etj.

Pretendimet e mësipërme janë marrë në konsideratë nga Komisioni, i cili, në vendim²⁰, ka pranuar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi mosparaqitja e dokumenteve të plota për këtë periudhë është për shkaqe të arsyeshme, marrë në konsideratë këtu realitetin social-ekonomik të kohës, duke sjellë në vëmendje trazirat e vitit 1997 dhe luftën e Kosovës, të nisur në fillim të vitit 1998, fakte këto të njohura botërisht, të cilat kanë sjellë si pasojë mosfunksionimin normal të institucioneve shtetërore të administratës qendrore dhe lokale në një vend kufitar si Tropoja.

Në mbështetje të parashikimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016²¹, që subjekti i rivlerësimit të gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentacionin e pretenduar, duhet të vërtetohet se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër. Trupi gjykues vlerësoi se faktet e cituara nga subjekti i rivlerësimit, ndonëse janë fakte të njohura botërisht, vetëm si të tilla nuk mund të kualifikohen se shërbejnë për të provuar pamundësinë objektive të subjektit të rivlerësimit për të gjetur dokumentacionin e pretenduar. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë në asnjë formë se dokumentacioni nuk mund të përftohet, për arsye të cilat janë përtej kontrollit të tij. Provueshmëria e këtij aspekti nga subjekti i rivlerësimit është kusht i përcaktuar shprehimisht nga pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, mbi bazën e të cilës institucionet e rivlerësimit legjitimohen të konstatojnë pamundësinë objektive.

28. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i Komisioneres Publike, në ankim, se të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti tregtar i familjes Ç., për periudhën 1998-2002, nuk duhen përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të kësaj familjeje është i pabazuar. Për pasojë, në analizën financiare, me qëllim kontrollin për financimin e blerjes së pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë”, të ardhurat *neto* të realizuara nga aktiviteti tregtar nga “A. Ç.” Person Fizik, për periudhën janar 1998-mars 2002, në shumën 3.825.000 lekë, do të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.
29. Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur nga puna si përkthyes në shërbim të organizatave ndërkombëtare, Komisionerja Publike ka pretenduar, në ankim, se këto të ardhura nuk duhen përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të familjes Ç., që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë”.

29.1. Komisioni, në vendim,²² ka arsyetuar se: *Sa i përket të ardhurave të pretenduara nga puna e bashkëshortes së subjektit si përkthyes dhe në shërbim të organizatave ndërkombëtare, Komisioni vëren se personi i lidhur ka bërë përpjekje të vazhdueshme (edhe para dërgimit të*

²⁰ Faqja 30, paragrafi i parë i vendimit të Komisionit.

²¹ Neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “[...] 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetohet institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”.

²² Faqja 31 e vendimit të Komisionit.

pyetësorëve në funksion të hetimit administrativ të kryer) për sigurimin e dokumentacionit ligjor për të provuar përfitimin e tyre. Në këtë kuptim, trupi gjykues çmon se edhe në këtë rast, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur janë gjendur në kushtet e pamundësisë objektive për sigurimin e dokumentacionit të plotë ligjor për të provuar përfitimin e këtyre të ardhurave, në përputhje me parashikimet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Por, nga ana tjetër, pas përpjekjeve të bëra evidentohen se janë siguruar indicie e prova të tërthorta, të cilat tregojnë se personi i lidhur ka punuar me organizatat ndërkombëtare (UNHCR dhe WFP), për periudhën që i përket viteve 1999 - 2000 dhe ka përfituar të ardhura nga puna e kryer, por mbetet i paqartë përcaktimi i detyrimit për pagesën e tatimit mbi to. Në vlerësim të këtyre të dhënave, si dhe koherencës së treguar në deklarinë e përfitimit të këtyre të ardhurave, Komisioni vendosi që në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, për efekt analize të pranojë “me rezervë” përfitimin e këtyre të ardhurave sipas deklarinë të bërë nga subjekti, në mbështetje të pohimeve të dhëna nga përfaqësuesja e WFP në Shqipëri, vlerësuar kjo rrethanë sigurisht në kushtet e një niveli më të ulët provueshmërie, për sa kohë kemi të bëjmë me të ardhura të përfituara nga personi i lidhur shumë vite përpara martesës dhe fillimit të bashkëjetesës. Komisioni çmon se, si një nga mjetet për kërkimin e provës, në kuptim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, deklarinë i dhënë nga ish-punëdhënësi direkt i bashkëshortes së subjektit për atë periudhë merr vlerë provuese të rëndësishme – i kombinuar me indiciet e tjera të evidentuara në e-mail-et e shkëmbyera nga personi i lidhur me adresat zyrtare elektronike të këtyre organizatave. Për rrjedhojë, në vlerësimin përfundimtar të të ardhurave të familjes Ç., do të përfshihet “me rezervë” edhe shuma prej 3.263.000 lekësh, me burim krijimi punën e personit të lidhur në organizatat ndërkombëtare.

29.2. Komisionerja Publike, në ankim, në kundërshtimin e vlerësimit të mësipërm të Komisionit, ka argumentuar se të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur nga puna si përkthyes në shërbim të organizatave ndërkombëtare, në shumën 3.263.000 lekë, nuk duhen përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të familjes Ç., pasi:

- (i) Gjatë hetimit administrativ, rezultojnë të jenë referuar vlera të ndryshme dhe kontradiktore lidhur me të ardhurat e pretenduara, pasi në aktin “Relacion shpjegues”, të depozituar bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit, nga personi i lidhur deklarohen të ardhura në shumën 600 dollarë/muaj, ndërsa gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se të ardhurat e realizuara kanë qenë në shumën 1.300 dollarë/muaj;
- (ii) Lidhur me këto të ardhura, në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 21.11.2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...] këto të ardhura nuk kanë qenë asnjëherë të dokumentuara, pasi ajo është paguar cash;
- (iii) Subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar marrëdhënien e punësimit, realizimin faktit të këtyre të ardhurave dhe as ligjshmërinë e tyre.

29.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime konfirmoi qëndrimin e Komisioneres Publike në ankim, ndërsa në konkluzionet përfundimtare mbajti qëndrimin e pasqyruar në paragrafin 22.3 më sipër në këtë vendim.

29.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, mbajti të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar, në mënyrë të përmbledhur se, fakti që znj. A. Ç. ka ushtruar funksione të mirëfillta pune si përkthyes dhe asistente pranë misioneve ndërkombëtare humanitare të UNHCR dhe HCC, të cilat gjatë periudhës prill 1999-shtator 2000, kanë qenë të vendosura në qytetin e Tropojës, nuk është një pretendim i pabazuar në prova, por është i mbështetur në dokumentacion të qartë dhe të formalizuar edhe nga akte zyrtare me fuqi të plotë provuese. Referuar këtyre akteve, rezulton se për periudhën 18-mujore të angazhimit të saj, znj. A. Ç. ka përfituar një shumë totale prej 23.400 dollarësh amerikanë ose 3.263.000 lekësh, sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka nënvizuar se marrëdhënia e përkohshme e punësimit me këto organizata të huaja humanitare nuk mund të krahasohet me një marrëdhënie pune të formalizuar në kuptimin klasik, sipas së drejtës shqiptare, por kjo nuk mund të përjashtojë vlerën juridike të të ardhurave të përfituara, sidomos kur këto janë vërtetuar me deklaratime të besueshme, të dhëna nga persona me njohje të drejtpërdrejtë të fakteve dhe të përforcuara me dokumentacion zyrtar të depozituar në formë noteriale. Sipas subjektit të rivlerësimit, përmbushen kushtet e parashikuara nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të vlerësuar se pamundësia për të administruar dokumentacion të plotë mbështetës për këto të ardhura është pasojë e një situatë objektive. Moskonsiderimi i kësaj vlere nga Komisionerja Publike, sipas subjektit të rivlerësimit, përbën jo vetëm shkelje të parimit të vlerësimit të plotë dhe të drejtë të provave, por edhe neglizhencë në zbatimin e standardit të përshtatjes së barrës së provës në kushtet e mungesës objektive të dokumentacionit, siç parashikohet në kuadrin ligjor të rivlerësimit.

30. Nga aktet e administruara nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se:

30.1. Në relacionin shpjegues që shoqëron deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur ka deklaruar se: *Përpos kësaj, dua të shtoj që unë personalisht, për shkak të njohjes së gjuhës së huaj angleze, në mënyrë shumë të mirë, kam ushtruar edhe funksionin e përkthyeses në këtë kohë pranë misioneve ndërkombëtare apo televizioneve të ndryshme, duke siguruar të ardhura personale shumë të mëdha për kohën (çdo muaj mbi 600 dollarë apo dhe raste të ndryshme edhe 1.000 marka gjermane - monedha e kohës), të cilat nisur nga koha e largët apo edhe situata konkrete efektive nuk kanë qenë asnjëherë të dokumentuara, pasi për këtë funksion (përkthyeses) paguhesha cash (me lekë në dorë). Të njëjtin deklaram, subjekti i rivlerësimit e ka bërë edhe pranë ILDKPKI-së, referuar “Procesverbalit mbi shpjegimet e subjektit deklarues”, të mbajtur në datë 21.11.2014.*

30.2. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Në periudhën prill 1999 - shtator 2000, A. ka punuar si përkthyes pranë misioneve UNHCR dhe HCC në ndihmë të refugjatëve kosovarë, misione këto të vendosura dhe në qytetin e Tropojës. Në këtë detyrë ajo paguhej cash në masën 1.300 dollarë në muaj. [...] Në këtë periudhë të ardhurat*

janë 23.400 dollarë, të cilat të konvertuara në lekë me kursin e kohës (referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë) kapin shumën 3.263.000 lekë. Mbahet në rezervë kjo shumë pasi kursi i konvertimit i kohës, në tregun e lirë ishte më i madh se ai zyrtar i publikuar nga Banka e Shqipërisë. Po kështu në referim të ligjit të kohës nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33, detyrimet tatimore nuk paguheshin nga A..

30.3. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] nisur nga barra e provës së ngarkuar nga Komisioni, përsa i përket këtyre të ardhurave, A. dhe unë kemi bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar çdo dokument/të dhënë/indicie të mundshme për të provuar përfitim të tyre. Kështu, gjatë këtyre ditëve (30 qershor 2023 – 13 Korrik 2023) pati dhe një përpjekje të A. për të kontaktuar krahas znj. P. P. (I.–mbiemri i saj i vajzërisë), e cila dispononte kopje vetëm të një letre rekomandimi nga OSBE dhe të një oferte punësimi për përkthyes në terren nga WFP, që na i vuri në dispozicion, ku provohet angazhimi i saj në atë kohë, edhe persona të tjerë që kanë punuar po përkthyes, apo personel mbështetës në këtë periudhë dhe për këto organizata (si përkthyesit z. A. M., znj. V. N., znj. B. M., apo dhe shoferët R. e M. M., bashkëqytetar me A.), po as ata nuk kishin ndonjë dokument provues. Kjo jo vetëm për periudhën kur kërkohet ky informacion që ka kaluar mbi 23 vjet, por kryesisht për faktin që në atë kohë të gjithë, sikurse dhe A. kanë qenë ose nxënës në shkollë të mesme, ose studentë, apo shoferë që nuk vlerësonin formalitetet. [...] Komisioni duhet të marrë në konsideratë rrethanën se për shkak të kalimit të kohës së gjatë edhe pas përpjekjeve të bëra, nuk u individualizua organizata e regjistruar në organet tatimore shqiptare apo degë e saj, nga e cila janë përfutur këto të ardhura, me qëllim evidentimin e marrëdhënies konkrete (nëse kemi pasur të bëjmë me marrëdhënie punësimi apo shërbimi), si edhe nuk u evidentua ekzistenca e ndonjë kontrate e në këtë kuadër të verifikimit të përgjegjësisë për mbajtjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, kjo pasi arkiva e dokumentacionit dhe gjithçka tjetër që lidhej me veprimtarinë është tërhequr nga ana e tyre në përfundim të misioneve. Gjithashtu, Komisioni duhet të vlerësojë faktin e njohur botërisht se në atë periudhë disa organizata ndërkombëtare kanë operuar me intensitet të lartë në rrethin e Tropojës, për shkak të krizës humanitare që kishte shkaktuar lufta e Kosovës. [...] Në këtë kuptim, gjendur në kushtet e pamundësisë objektive (neni 32/2, i ligjit 84/2016), si edhe bazuar në të gjitha rrethanat e evidentuara si më sipër, kërkohet që të merret në konsideratë deklarimi i bërë nga përfaqësuesja e organizatës ndërkombëtare, mbi vlerën e të ardhurave të përfutuara nga bashkëshortja ime, duke shtuar si të ardhura të përfutuara për periudhën para blerjes së apartamentit, shumën prej rreth 3.263.000 lekë.

30.4. Për të provuar deklaratimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka depozituar aktet:

(i) Komunikime me anë të postës elektronike të znj. A. P. me Zyrën Qendrore të UNHCR në Shqipëri. Në e-mail-in e datës 24.06.2020, znj. P. ka kërkuar pranë kësaj organizate ndërkombëtare, një vërtetim ose dëshmi lidhur me angazhimin e saj si përkthyes e gjuhës shqipe pranë UNHCR dhe HCC në Tropojë, Bajram Curri, gjatë krizës së refugjatëve në Kosovë, në vitet 1999-2000. Me anë të e-mail-it, datë 26.06.2020, zyra e UNHCR në Shqipëri i ka kërkuar znj. P. të dhëna lidhur me periudhën e saktë të punës, kontratën e punës nëse ka, emrin e mbikëqyrësit, si dhe e ka informuar se çdo e dhënë shtesë do të shpejtonte kërkimin, pasi skedarët e asaj kohe ishin

të kufizuar. Në *e-mail*-in e datës 27.06.2023, znj. P. referon pranë UNHCR Shqipëri, periudhën e punës prill 1998-shtator 1999, mos posedimin e kontratës së punës dhe emrat e personave me të cilët ka punuar ndër të cilët dhe znj. P. P. të cilën e ka referuar si mbikëqyrësen shqiptare. Me *e-mail*-in e datës 29.06.2020, zyra e UNHCR Shqipëri ka informuar znj. P. se: *Sipas burimeve tona, gjatë periudhës së përmendur, znj. P. P. nuk ka qenë anëtare e stafit të UNHCR-së. Ajo ka punuar për WFP-në, kështu që do të ishte mirë të kontaktoni znj. P. ose organizatën për të cilën ajo ka punuar.*

(ii) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.07.2021, me anë të së cilës znj. P. P. deklaron se: [...] znj. A. Ç. ka qenë e kontraktuar si përkthyes e gjuhës angleze dhe shoqëruese e personelit të huaj gjatë zhvillimit të veprimtarive humanitare të shpërndarjes së ndihmave për refugjatët e ardhur nga Kosova në periudhën prill 1999-shtator 2000. Unë kam qenë përgjegjësjë e shpërndarjes së ndihmave në rrethin e Tropojës për UNHCR dhe HCC dhe znj. Ç. ka qenë personi që kishte njohje shumë të mirë të gjuhës angleze. Znj. A. Ç. është paguar për shkak të ofrimit të shërbimit të saj të përkthimit dhe shoqërimit të koordinatorëve të huaj në zonat dhe fshatrat e rrethit Tropojë, në shumën mujore 1.300 dollarë amerikanë. Pagesa kryhej cash në dorë. Ajo ka shoqëruar personelin e UNHCR dhe të WFP së bashku me shoferin, në të gjithë rrethin e Tropojës për të kontrolluar dhe ndihmuar me ndihma të ndryshme sipas nevojës, refugjatët kosovarë të shpërndarë në rrethin e Tropojës. [...].

(iii) Letër rekomandimi, datë 14.06.1999, në gjuhën angleze, e z. P. G., shef i Zyrës në terren i OSBE-së në Bajram Curri (rrethi Tropojë) nga data 18.06.1998-12.06.1999, i cili, ndër të tjera, referon se znj. P. P. kishte punuar për UNWFP gjatë krizës së refugjatëve në verën e vitit 1998, më pas u punësua si asistente përkthyes e përkohshme e Zyrës në Terren e OSBE-së dhe më pas si asistente e koordinatorës së programit *ad hoc* për Cap Anamur, znj. A. S., vëzhguese e OSBE-së. Z. G. dëshmon punën e bërë nga znj. P. për regjistrimin dhe shpërndarjen e ndihmave për refugjatët kosovarë, në këtë periudhë, 1998-1999.

(iv) Ofertë për punësim të përkohshëm, datë 30.06.1998, e znj. E. H., përfaqësuesja e WFP²³, drejtoreshë vendore, sipas së cilës znj. P. P. i ofrohet punësimi i përkohshëm si asistente/përkthyes në terren në zyrën e kësaj organizate në Bajram Curri, për periudhën 19.06.1998-18.08.1998, me pagesë 306 lekë/orë, me kohëzgjatje ditore të punës nga ora 8.30-17.00 dhe pagesë për çdo orë shtesë prej 459 lekësh.

30.5. Në mbështetje të pretendimeve të parashtruara gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit së bashku me parashtrimet paraqiti akte të cilat u administruan në cilësinë e provës, nga përmbajtja e të cilave, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

30.5.1. UNCHR-ja, në shkresën me nr. {***}, datë 19.06.2025, drejtuar subjektit të rivlerësimit²⁴, ka përcjellë informacionin sa i takon pagës *bruto* minimale dhe dietave për kategorinë e

²³ Organizata humanitare ndërkombëtare WFP- World Food Programme.

²⁴ Në kërkesën e datës 16.06.2025, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar informacion përfaqësues të UNCHR-së në Shqipëri në lidhje me vlerën minimale dhe maksimale të pagesës për përkthyesit dhe stafit të kontaktuar prej tyre gjatë luftës së Kosovës, në zonën e Bajram Currit, Tropojë, Qarku Kukës, për vitet 1999-2000.

punonjësve të shërbimit të përgjithshëm, për periudhën 01.10.1999 – 01.11.2000, të cilat varrojnë nga 5.656 dollarë amerikanë në vit deri në maksimumin prej 15.168 dollarë amerikanë në vit. Kjo organizatë ka referuar, gjithashtu, se pagesa në atë periudhë është kryer me para në dorë. Në shkresën nr. {***}, datë 27.09.2025, drejtuar subjektit të rivlerësimit²⁵, UNCHR-ja ka përcjellë marrëveshjen midis Qeverisë së Shqipërisë dhe kësaj organizate, nënshkruar më datë 13.04.1994, në të cilën në nenin 10, shkronjat “e” dhe “f”, parashikohet përjashtimi nga çdo lloj tatimi për çdo lloj të ardhure, të përfituar nga angazhimi i individëve në projekte të UNCHR-së në Shqipëri;

30.5.2. WFP, me seli në Romë, Itali, në *e-mail*-in e datës 15.10.2025, përcjellë znj. A. P.²⁶, është përgjigjur për pamundësinë objektive të gjetjes së informacionit të kërkuar prej saj;

30.5.3. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe deklaratat noteriale të z. R. M. që ka punuar si shofer dhe shoqërues pranë organizatave humanitare UNCHR, HCC të cilat vepronin në qarkun Kukës në vitet 1999-2000; të z. A. M. i cili deklaroi ndër të tjera se gjatë periudhës 1999-2000 ka punuar pranë UNCHR dhe HCC si përkthyes i gjuhës angleze; të shtetasve kosovarë A. F. dhe B. K., të cilët kanë si objekt të deklarimeve të tyre faktin se znj. A. P. ka shërbyer si përkthyes e gjuhës angleze, shoqëruese e gazetarëve dhe televizioneve të huaja, si dhe ndihmonte në shpërndarjen e ndihmave humanitare së bashku me bashkëmoshatarët e saj, gjatë periudhës së luftës së Kosovës;

30.5.4. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, me shkresën nr. {***} prot, datë 14.10.2025, i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit urdhrin nr. 34, datë 07.04.1999 e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave, sipas së cilit ndërpritet puna mësimore edukative në të gjitha kategoritë e shkollave të prefekturës së Kukësit. Sipas këtij urdhri, i gjithë personeli mësimor i shkollave vihet në dispozicion të pushtetit lokal për kryerjen e detyrave të emergjencës të krijuar në kushtet e situatës humanitare.

- 31.** Nga analizimi i të dhënave/informacionit që derivon nga aktet e mësipërme të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision si dhe gjatë gjykimit në Kolegj, për punësimin e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se ka indicie lidhur me punësimin e znj. A. P. (Ç.) si përkthyes pranë organizatave ndërkombëtare humanitare gjatë periudhës prill 1999 - shtator 2000, por në kushtet e mungesës së ekzistencës së një kontrate pune, apo një dokumentacioni që provonte përmbushjen e elementëve të detyrueshëm të një marrëdhënie pune, të hartuar në periudhën në fjalë, aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk mund të përbëjnë prova të plota e të mjaftueshme, të tilla që të mos vënë në diskutim ekzistencën e burimit të ligjshëm të të ardhurave të pretenduara. Edhe pse këto akte japin indicie për ekzistencën e një veprimtarie të

²⁵ Në kërkesën e datës 18.08.2025, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar informacion përfaqësues së UNCHR-së në Shqipëri, në lidhje me mënyrën se si është vepruar lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore në kuadër të të ardhurave të përfituara nga angazhimi i individëve në projekte të UNCHR-së në Shqipëri referuar viteve 1999-2000, nëse ka pasur ndonjë përjashtim nga pagimi i detyrimeve tatimore gjatë krizave humanitare.

²⁶ Me shkresën e datës 02.09.2025, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. A. P., i është organizatës World Food Programe, në adresën zyrtare të saj, me kërkesën për informacion/vërtetim mbi angazhimin e saj si përkthyes e gjuhës shqipe në bashkëpunim me këtë organizatë në Tropojë (Bajram Curri), gjatë periudhës së krizës së refugjatëve të Kosovës 1999–2000, nën drejtimin e znj. P. P..

personit të lidhur pranë organizatave humanitare ndërkombëtare, si dhe besueshmërinë për ofrimin prej saj të një pune apo shërbimi pranë tyre, ato nuk provojnë shumën e të ardhurave të përfituara nga ky punësim. Në kushtet kur sipas parashikimit të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës në procesin e rivlerësimit dhe ai nuk ka mundur të provojë me dokumentacion të ardhurat e pretenduara prej tij, zbatimi i nenit 32, pika 2 e ligjit, për të provuar të gjitha elementet e një marrëdhënieje, nuk gjendet relevant. Në rastin konkret, përveç se mungon kontrata e punësimit/dokumentacioni financiar/ligjor që provon angazhimin si përkthyes të znj. A. P. (Ç.), e cila do të kishte të përcaktuar pagën e përfituar prej saj si ofruese e shërbimit si përkthyes, mungojnë edhe të dhëna apo fakte të tjera që në mënyrë qoftë edhe të tërthortë, të provonin deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me masën e të ardhurave të siguruara nga punësimi i personit të lidhur si përkthyes. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se gjendet në pamundësi për shkak të kohës së largët, që të disponojë dokumentacionin që provon të ardhurat e siguruara nga punësimi i personit të lidhur pranë organizatave ndërkombëtare, nuk është një pretendim i drejtë, për sa kohë që vetë përmbajtja e nenit 32, pika 2 parashikon vendosjen në kushtet e zbatimit të kësaj dispozite për të tjera rrethana, si zhdukja e dokumentacionit, pamundësia për ta gjetur dokumentin, që në thelb tregojnë se duhet të ketë mjaftueshëm të dhëna që dokumenti ka ekzistuar, por që nuk gjendet për shkaqe që nuk varen nga subjekti i rivlerësimit. Në rastin konkret nuk rezulton të provohen në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat e kësaj dispozite.

32. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga personi i lidhur nga angazhimi i saj si përkthyes pranë organizatave ndërkombëtare në periudhën prill 1999-shtator 2000, në shumën 3.263.000 lekë, mbeten të ardhura të paprovuara, në nivel deklarativ, për rrjedhojë, këto të ardhura konsiderohen se nuk plotësojnë kriteret e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke konfirmuar qëndrimin e Komisioneres Publike në ankim se ato me të drejtë nuk duhen përfshirë si të ardhura në analizën financiare të kryer nga Komisioni.
33. Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur si asistente/mjeke promovoni pranë shoqërisë “{***}” ShPK, të pretenduara nga Komisionerja Publike se nuk duhen përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të familjes Ç., trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si më poshtë.

33.1. Komisioni, në vendim²⁷, ka arsyetuar se: [...] duke e analizuar këtë marrëdhënie nën prizmin e një shërbimi të kryer nga personi i lidhur si individ, detyrimi për deklarin, mbajtjen dhe pagesën e tatimit mbi këto të ardhura i takonte shoqërisë “{***}” ShPK, e cila, në këtë rast, do të luante rolin e agentit tatimor. Si konkluzion, për sa u argumentua më sipër, si dhe në kushtet kur rezultoi e provuar me dokumentacion justifikues ligjor marrëdhënia e bashkëshortes së subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK, marrëdhënie e cila rezulton se është brenda fushës së veprimtarisë së profesionit të saj, Komisioni çmon të pranojë, megjithëse me rezervë dhe të reflektojë në

²⁷ Faqja 33 e vendimit të Komisionit.

*analizën e të ardhurave si të ardhura shtesë nga kjo marrëdhënie, vlerën e të ardhurave të referuar në shkresën e shoqërisë “{***}” ShPK, në total në shumën 1.400.000 lekë.*

33.2. Komisionerja Publike, në ankim, në kundërshtimin e vlerësimit të mësipërm të Komisionit, ka argumentuar se të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur si asistente/mjeke promovioni, pranë shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën 1.400.000 lekë, për periudhën mars 2002 - qershor 2005, nuk duhen përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të familjes Ç., pasi:

(i) bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit gjatë hetimit administrativ, nuk provohet përfitimi faktik dhe as ligjshmëria e tyre duke mbetur kështu në nivel deklarativ;

(ii) pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ se këto të ardhura janë realizuar prej vitit 2002, bie ndesh me deklarin e vetë personit të lidhur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në aktin “*Relacion shpjegues*” bashkëlidhur kësaj deklarate, ku, znj. Ç. ka referuar të ardhura si mjeke, duke filluar nga viti 2005. Konkretisht, ka deklaruar të ardhura si mjeke promovioni nga shoqëria “{***}” ShPK, në vlerën 133.000 lekë dhe jo në shumën e pretenduar nga subjekti, në total prej 1.533.000 lekë.

33.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjyqimit në Kolegj, në parashtrime konfirmoi qëndrimin e Komisioneres Publike në ankim, ndërsa në konkluzionet përfundimtare mbajti qëndrimin e pasqyruar në paragrafin 22.3 më sipër në këtë vendim.

33.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjyqimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, mbajti të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar, në mënyrë të përmbledhur se, marrëdhënia me shoqërinë “{***}” ShPK është zhvilluar më së shumti në kohën kur personi i lidhur, znj. P. (Ç.) ka qenë studente në fakultetin e Mjekësisë dhe në këtë periudhë ajo ka qenë e përqendruar tek studimet dhe jo tek interesi i formalitetit të marrëdhënies së saj me shoqërinë, apo për më tepër tek kujdesi i shtuar për pagesat ose jo të detyrimeve fiskale, për të cilat ajo ka qenë në mirëbesim, duke menduar se ato janë kryer nga vetë shoqëria, në kushtet kur kjo marrëdhënie ka qenë vijuese që nga viti 2002 e në vijim deri në vitin 2006 dhe për më tepër me të njëjtën vlerë page. Në këtë periudhë të largët kohe, personi i lidhur nuk ka pasur asnjë detyrim për të ruajtur dhe evidentuar dokumentacionin formal të ekzistencës së kësaj marrëdhënieje, porse ka qenë detyrim i shoqërisë, e cila ka shpjeguar arsyet e mospasjes në ruajtje të asnjë lloj dokumentacioni. Sipas subjektit të rivlerësimit, marrëdhënia për periudhën 2002-2005, ka qenë marrëdhënie shërbimi e përkohshme dhe në referencë të legjislacionit tatimor në fuqi në atë kohë, por edhe Kodit të Punës, pagesat janë kryer në formë “*cash*”, ndërkohë që detyrimet fiskale i takonin shoqërisë si subjekti pages dhe jo individit të angazhuar. Ky qëndrim përse i përket përgjegjësisë tatimore, është pranuar tashmë edhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit. Për këtë arsye, të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e punësimit/shërbimit të personit të lidhur pranë shoqërisë “{***}” ShPK në pretendimin e subjektit të rivlerësimit, në shumën prej 1.533.000 lekësh, duhet të njihen si burim i ligjshëm

34. Nga aktet e administruara nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se:

34.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka renditur në burimet e krijimit të pasurisë

“Apartament me sipërfaqe 97,5 m² në rrugën “{***}”, në Tiranë”, si vijon: *të ardhurat familjare të siguruara nga aktiviteti (biznesi) i tyre tregtar i filluar që nga viti 1995, fillimisht në emrin e bashkëshortes e më pas familjarëve të saj dhe të ardhurat personale të punës si mjeke e përgjithshme, mjeke promovimi.*

Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike”, personi i lidhur ka deklaruar: *Paga si mjeke promovimi part-time pranë kompanisë farmaceutike “{***}” ShPK, në vlerën 133.000 lekë.*

Bashkëlidhur deklaratës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur Vërtetimin mbi Bazën e Vlerësueshme dhe Pagën Neto Mesatare nr. {***} prot., datë 17.10.2016, sipas të cilit znj. A. Ç., për periudhën tetor 2005 - janar 2006, ka realizuar të ardhura në masën 133.000 lekë, mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi në subjektin “{***}” ShPK.

34.2. Në “Relacionin shpjegues” të dorëzuar nga personi i lidhur bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur ka deklaruar: *“Më tej dua të shtoj se gjatë viteve 2005-2008, siç edhe jua kam dokumentuar, unë kam qenë drejtoreshë e Qendrës Shëndetësore Komuna {***}, si dhe mjeke e përgjithshme me të ardhura të konsiderueshme (vërtetim të cilin ju e dispononi paraprakisht), si dhe kam kryer edhe paralelisht detyrën e mjekes së promovimit për disa firma farmaceutike, gjë për të cilën dhe jam paguar (sipas vërtetimeve respektive në vlerat përkatëse që ju i dispononi paraprakisht)”.*

34.3. Në deklaratën e interesave private të vitit 2008, deklarimi për herë të parë i znj. P., në cilësinë e personit të lidhur, ajo ka deklaruar si burime krijimi të “Apartament me sipërfaqe 97,5 m² në rrugën “{***}”, në Tiranë”: *Blerë me të ardhurat nga familja e bashkëshortes nga aktiviteti i tyre tregtar dhe nga kursimet familjare e personale të punës si mjeke e përgjithshme.*

34.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *[...] Në periudhën mars 2002 deri shkurt 2006 (pa përfshirë muajin shkurt të këtij viti), A. ka punuar si “asistente mjeke promovimi” në vitet 2002-2005 dhe “mjeke promovimi” me kontratë në vitet 2005-2006, pranë shoqërisë “{***}” ShPK, vërtetuar kjo si me vërtetimin nr. {***} Prot. datë 07.04.2023 të shoqërisë, ashtu dhe me shkresën nr. {***} prot., datë 18.10.2016 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë. [...] Në këtë periudhë të ardhurat janë 1.533.000 lekë”.*

34.5. Në përgjigje të kërkesës së drejtuar nga znj. A. P., shoqëria “{***}” ShPK ka lëshuar Vërtetimin nr. {***} Prot. datë 07.04.2023, me anë të të cilit, administratori i shoqërisë ka vërtetuar se znj. A. Ç. (P.) ka pasur me këtë shoqëri, marrëdhënien e punës si më poshtë:

Mars 2002 - qershor 2005, me kontratë provizore pune (këtu përjashtohen muajt korrik e gusht të çdo viti që nuk ka pasur prezencë pune) me detyrën e asistentes mjeke promovionale.

Tetor 2005 - shkurt 2006, me kontratë të rregullt pune si mjeke promovionale dhe si konsulente teknike.

Paga ka qenë 40.000 lekë në muaj. Kërkesën për shoqërimin e këtij vërtetimi me mandat pagesë nuk e plotësoj dot, pasi deri para vitit 2014, financa e shoqërisë i ka pasur të ruajtura të gjitha

mandat pagesat dhe çdo mandat hyrje/dalje malli, por pas këtij viti ekzekutoheshin të gjitha dokumentet financiare për më tepër se 5 vite.

34.6. Në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar deklarimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 2, duke shtuar: *Me shoqërinë “{***}” ShPK, marrëdhënia për periudhën 2002-2005 ka qenë “shërbimi” dhe sipas legjislacionit në fuqi njihej pagesa “cash”, ku detyrimet fiskale duhet t’i ketë paguar shoqëria. Pra, në total të ardhurat nga marrëdhënia e shërbimit/punësimit të A. pranë shoqërisë “{***}” ShPK, në periudhën mars 2002 deri shkurt 2006, janë në shumën 1.533.000 lekë, [...] dhe kërkoj nga Komisioni që t’i njohë si të tilla.*

- 35.** Në analizë të pretendimit të Komisioneres Publike, në raport me vlerësimin e Komisionit dhe situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vëren se duket i drejtë konstatimi i Komisioneres Publike në ankim, se të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur nga punësimi si asistente mjeke promovionale pranë shoqërisë “{***}” ShPK në shumën 1.400.000 lekë, janë pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, për herë të parë, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pasi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, personi i lidhur kishte deklaruar vetëm shumën prej 133.000 lekësh të përfituar si pagesë nga punësimi *part-time*, pranë kësaj shoqërie. Kjo shumë e deklaruar nga personi i lidhur korrespondon me pagën mbi të cilën i janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore nga shoqëria në fjalë, për periudhën tetor 2005-janar 2006, sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë përcjellë personit të lidhur në Vërtetimin nr. {***} prot., datë 17.10.2016 mbi Bazën e Vlerësueshme dhe Pagën Neto Mesatare. Dokumenti i vetëm mbi të cilin subjekti i rivlerësimit ka mbështetur pretendimin e tij për përfitimin e të ardhurave të cituara si më sipër, është vërtetimi i lëshuar nga administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, i cili ka referuar periudhën e punësimit, pozicionin e punës si asistente mjeke promovionale dhe pagën prej 40.000 lekësh në muaj për znj. A. Ç., për periudhën në fjalë.

Në këtë vërtetim, administratori i shoqërisë ka pranuar gjithashtu edhe punësimin e znj. Ç., për periudhën tetor 2005-shkurt 2006 si periudhë punësimi *me kontratë të rregullt pune*, periudhë e cila përkon dhe me pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga shoqëria “{***}” ShPK, kundrejt personit të lidhur, ndërsa periudhën mars 2002-qershor 2005, administratori i shoqërisë e ka cilësuar si periudhë punësimi me *“kontratë provizore pune (këtu përjashtohen muajt korrik e gusht të çdo viti që nuk ka pasur prezencë pune)”*, periudhë për të cilën nuk është vërtetuar pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore. Nga sa më sipër, administratori i shoqërisë i referohet një kontrate pune *provizore*, e cila duket se nënkupton një kontratë të përkohshme pune të lidhur me znj. A. Ç.. Kodi i Punës, në fuqi në kohën e krijimit të kësaj marrëdhënieje pune, në nenin 140 të tij parashikonte kontratën e punës me kohëzgjatje të caktuar si një nga llojet e kontratës së punës, e cila dallonte nga kontrata e punës me kohëzgjatje të pacaktuar vetëm për sa i përket plotësimit të kushteve specifike objektive për caktimin e afatit në marrëdhënien kontraktore të punës që kishin të bënin me natyrën e përkohshme të detyrës, që do të justifikonin lidhjen e saj. Referuar parashikimit ligjor të mësipërm, detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit janë të njëjta në të dy llojet e kontratave të cilat janë cilësuar nga administratori i shoqërisë si “kontratë provizore” dhe

si “kontratë e rregullt” pune, e me rëndësi për procesin e rivlerësimit, afati i kohëzgjatjes së kontratës së punës nuk përjashton pagimin nga punëdhënësi të detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore e, për pasojë, edhe të detyrimeve të tjera tatimore që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Legjislacioni i kohës, konkretisht ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në nenin 13, pika 2 dhe 3, parashikonte se kontributet e personave të punësuar nën një kontratë pune do të derdeshin nga punëdhënësi, i cili ishte përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Edhe ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, në fuqi në kohën kur është shtrirë marrëdhënia e punës, në nenin 6, pika 2 parashikonte se punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit.

35.1. Sa i përket tatimit mbi të ardhurat, në kohën e shtrirjes së marrëdhënies së punës (mars 2002-qershor 2005) në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, në nenin 8, shkronja “a” përcaktohej se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: *a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës,* dhe neni 10 parashikonte se çdo punëdhënës, që paguan një pagë a shpërblim në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës, mbante tatimin mbi të ardhurat personale dhe e derdhte tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore.

Administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, në vërtetimin e lëshuar prej tij, nuk ka paraqitur ndonjë të dhënë lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore nga shoqëria për punën apo shërbimin e ofruar nga znj. P. (Ç.). Ai ka shprehur pamundësinë për vënien në dispozicion të personit të lidhur të mandat pagesave që do të vërtetonin dhënien e pagës znj. P. (Ç.) në shumën 40.000 lekë në muaj, si dhe nuk ka paraqitur asnjë kontratë pune, apo një dokument të ngjashëm me të, që të vërtetonte marrëdhënien e pretenduar të punësimit të znj. P.(Ç.).

Trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë marrëdhënien e pretenduar të punësimit të personit të lidhur në shoqërinë “{***}” ShPK për periudhën 2002-2005 dhe as të ardhurat e pretenduara si të krijuara prej saj. Në këto kushte, në vlerësim të trupit gjykues, fakti që përgjegjësia për pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura i përkiste shoqërisë punëdhënëse, nuk është relevante për zgjidhjen e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, referuar jurisprudencës së Kolegjit²⁸, për sa kohë nuk arrihet të provohet marrëdhënia e punësimit dhe masa e të ardhurave të pretenduara.

36. Për sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se për këto të ardhura, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, nuk u provua ligjshmëria e tyre e për pasojë mbetën në nivel deklarativ, duke konfirmuar qëndrimin e Komisioneres Publike për to.

37. Në kuadër të analizës së të ardhurave të familjes Ç. të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë”, trupi gjykues mori në shqyrtim dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e realizuara

²⁸ Vendimi i Kolegjit nr. 15(JR)/2021.

nga prindërit e personit të lidhur, në fushën e grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të bimëve medicinale dhe aktivitetit të transportit të tyre. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet dhe në konkluzionet përfundimtare, gjatë gjykimit në Kolegj, ka pretenduar se z. I. Ç. ka ushtruar veprimtari të vazhdueshme ekonomike në fushën e grumbullimit, përpunimit, tregtimit transportit të bimëve medicinale, për periudhën janar 1996 - shtator 2007, të ardhurat e përfituara kanë qenë në shumën 18 milionë lekë.

37.1. Trupi gjykues vëren se këto pretendime subjekti i rivlerësimit i ka paraqitur edhe gjatë hetimit administrativ, dhe Komisioni, në vendim²⁹, në lidhje me këto të ardhura, ka konkluduar: *“Komisioni gjen të pranueshëm pretendimin e subjektit se babai i bashkëshortes ka ushtruar aktivitet në fushën e grumbullimit, transportit dhe tregtimit të bimëve medicinale. Por, nga ana tjetër nuk ka asnjë evidencë mbi shumën e të ardhurave të përfituara dhe për pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me to. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se mbetet e karakterit deklarativ vlera e të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti i grumbullimit, transportit dhe tregtimit të bimëve medicinale dhe, si rrjedhojë, nuk do të përfshihen në analizë të të ardhurave të familjes Ç., të ardhura nga ky burim”*.

Ky konkluzion i arritur nga Komisioni nuk është kundërshtuar nga Komisionerja Publike në ankim.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se analiza e mëtejshme duhet të fokusohet vetëm në shqyrtimin e pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me shumën e të ardhurave të realizuara nga z. I. Ç. nga aktiviteti i pretenduar i grumbullimit, përpunimit, tregtimit dhe transportit të bimëve medicinale (në vijim “nga tregtimi i bimëve medicinale”), për periudhën janar 1996-shtator 2007, duke konsideruar të provuar faktin e ushtrimit të këtij aktiviteti nga babai i personit të lidhur, përsa kohë ky fakt i konkluduar nga Komisioni në vendim³⁰ nuk është kundërshtuar nga asnjë nga palët në këtë gjykim.

37.2. Për të provuar të ardhurat e përfituara nga z. I. Ç. nga tregtimi i bimëve medicinale, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjatë hetimit administrativ në Komision, mandat pagesa të lëshuara nga z. I. M. dhe nga shoqëria “{***}” ShPK në favor të z. I. Ç., për periudhën 1996-2010. Mandat pagesat përmbajnë numër rendor, datë, përshkrimin e veprimit financiar, emër mbiemër dhe nënshkrimin e marrësit dhe dhënësit të pagesës. Numrat e mandateve figurojnë në rend kronologjik në përputhje me rendin kronologjik të datave. Shuma totale e vlerave të arkëtuara, të dokumentuara në këto mandate pagesash, për periudhën objekt analize janar 1996-shtator 2007, është 1.687.450 lekë.

²⁹ Faqja 33 e vendimit të Komisionit.

³⁰ Në paragrafin “ç”, faqja 33 e vendimit, Komisioni ka analizuar tërësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, në vlerësim të të cilave ka arritur në konkluzionin se babai i bashkëshortes, z. I. Ç., është marrë me aktivitetin e grumbullimit, përpunimit, tregtimit dhe transportit të bimëve medicinale.

37.3. Gjatë gjykimit në Kolegj, me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentacionin e administruar në cilësinë e provës, me anë të të cilit synonte të provonte të ardhurat e përfituara nga z. I. Ç. nga tregtimi i bimëve medicinale, si më poshtë pasqyruar:

(i) Shkresë nr. {***} prot., datë 10.09.2025, të degës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tropojë, drejtuar znj. S. Ç., bashkëlidhur së cilës gjendet vërtetimi i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tropojë me nr. {***} prot., datë 12.03.2021, sipas të cilit nëna e personit të lidhur rezulton se ka tokë në pronësi në fshatin {***}, Tropojë që nga viti 1991 dhe rezulton e vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1996-2001 dhe 2005-2014;

(ii) Vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. {***} prot., datë 12.05.2021 me pagat përkatëse për znj. S. Ç., për periudhën 2002-2004;

(iii) Vërtetim datë 03.10.2018, për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për z. I. Ç., i siguruar si i vetëpunësuar, për periudhën 01.03.2005-31.12.2012;

(iv) Vërtetim nr. {***} prot., datë 15.09.2025, i Bashkisë Tropojë, Sektori i Pronave dhe Hartografisë, sipas të cilit z. S. Ç., babai i z. I. Ç., (i cili gjendet në të njëjtën përbërje familjare me djalin e tij sipas të dhënave të certifikatës së gjendjes civile të datës 15.09.2025), ka tokë bujqësore në fshatin {***}, Tropojë;

(v) Shkresë nr. {***} prot., datë 26.09.2025, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, sipas së cilës për zonën {***}, është kryer procesi i regjistrimit të fondit pyjor dhe kulllosor në bashkinë Tropojë;

(vi) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.09.2025 e z. I. dhe znj. S. Ç., prindërit e personit të lidhur, në të cilën ndërmjet të tjerave ata deklarojnë se kanë kryer aktivitet privat, kanë grumbulluar bimë çajore dhe medicinale në kullotat e zonës përreth, aktivitet të cilin e zhvillojnë ende.

37.3.1. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithashtu edhe aktin “Raport Vlerësimi”, datë 16.10.2025, përgatitur nga ekspertët e zgjedhur prej tij, z. B. Q., me gradën doktor i shkencave, agronom dhe vlerësues i pasurive të paluajtshme dhe znj. E. L., inxhinierë dhe vlerësuese e pasurive të paluajtshme.

Trupi gjykues, nga analizimi i raportit të vlerësimit, konstatoi se detyra e shtruar nga subjekti i rivlerësimit ndaj ekspertëve, ka qenë përcaktimi i të ardhurave të përfituara nga një fermer, për çdo vit të periudhës janar 1996 - shtator 2007, në mbledhje e tregtim të çajrave e bimëve medicinale, në bjeshkët e zonave kadastrale {***}, {***} dhe {***}, bimë të cilat janë kryesisht lule bliri, lule shtogu, trumëz, boronicë, agulçe, sherebelë, dellinjë e mollë e egër.

Sipas përmbajtjes së raportit të vlerësimit, në përlllogaritjen e të ardhurave në shumën 13.304.746 lekë, të realizuara nga një fermer nga bimët medicinale, për periudhën janar 1996 - shtator 2007, ekspertët janë bazuar në informacionet e përcjella në shkresat e institucioneve shtetërore, si dhe në literaturën vendase e të huaj, konkretisht:

i. botimin online nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mbi bimët mjekësore të Shqipërisë (2020);

ii. disertacionin e M.Sc. F. P. mbi bimët medicinale dhe aromatike në Shqipëri (2014);

iii. publikime në faqe interneti mbi bimët medicinale dhe aromatike, studimet e publikuara online nga University of Maine Cooperative Extension; informacionin e përcjellë në shkresën nr. {***} prot., datë 13.10.2025, të Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër, drejtuar subjektit të rivlerësimit, mbi të dhënat e rendimentit ditor të grumbullimit të çajrave dhe bimëve medicinale nga një fermer dhe çmimin në lekë/kg, për secilën bimë, për vitin 2024;

iv. informacionin e përcjellë nga INSTAT në *e-mail*-in e datës 14.10.2025, drejtuar subjektit të rivlerësimit, për koeficientët e rivlerësimit të çmimeve ndërmjet viteve 1996-2007, krahasuar me vitin 2024.

Referuar këtij informacioni ekspertët kanë llogaritur vlerën e të ardhurave vjetore të një fermeri nëpërmjet dy treguesve, çmimit mesatar vjetor të shitjes (lekë) për njësi (kg) dhe sasisë mesatare vjetore të vjeljes së bimëve medicinale. Çmimi mesatar vjetor për njësi është llogaritur si raport i çmimit mesatar të shitjes për vitin 2024 me koeficientin e rivlerësimit për secilin vit dhe secilën bimë. Sasia mesatare vjetore e vjeljes është llogaritur referuar rendimentit vjetor të një fermeri për secilën bimë, në periudhën 1996-2007. Në llogaritjen e rendimentit vjetor për secilën bimë janë konsideruar rendimenti ditor, ditët mesatare të punës (24 ditë në muaj), muajt sipas shpërndarjes së rendimentit në muajt prodhimtarë të vitit, duke marrë në konsideratë tipologjinë e secilës bimë si bimë të egra dhe jo të kultivuara, shpërndarjen e tyre të çrregullt në zonën e bjeshkëve ku është kryer vjelja.

38. Trupi gjykues, në vlerësim të situatës faktike të rezultuar si më sipër, çmoi se raporti i vlerësimit i përgatitur nga ekspertët e zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit shërben në krijimin e një panorame lidhur me tregtimin e bimëve medicinale në zonën ku është zhvilluar ky aktivitet nga familja Ç. dhe çmimin e tregtimit të këtyre produkteve në periudhën objekt analize. Në vlerësim të trupit gjykues, provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e familjes Ç., në harmoni me njëra-tjetrën, provojnë bindshëm që kjo familje ka përfitur në mënyrë të vazhdueshme të ardhura nga tregtimi i bimëve medicinale. Në këtë kontekst, si dhe duke mbajtur në vëmendje se znj. S. Ç. ka qenë e vetëpunësuar në bujqësi duke paguar kontributet e sigurimeve shoqërore, në periudhën objekt analize, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe objektiv përfundimin se nga ky aktivitet i zhvilluar nga familja Ç., duhet të konsiderohen të ligjshme vetëm të ardhurat, të cilat subjekti i rivlerësimit i provoi me dokumentacion justifikues financiar, mandat pagesat e lëshuara nga z. I. M. dhe nga shoqëria “{***}” ShPK në favor të z. I. Ç., për periudhën janar 1996 - shtator 2007, në shumën 1.687.450 lekë, të cilat u përfshinë në analizën financiare për verifikimin e pasurisë objekt kontrolli.

39. Komisionerja Publike në ankim dhe përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj kanë pretenduar, se *mundësia për kursim e familjes Ç., duhet përlllogaritur duke zbritur shpenzimet e jetesës nga totali i të ardhurave*, një pretendim i cili u konsiderua i drejtë nga trupi gjykues. Në ndryshim nga sa konkluduar Komisioni në vendim³¹,

³¹ Në vendim, Komisioni ka arsyetuar: “Si rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se personi i lidhur dhe prindërit e saj kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të provuara në nivel ligjor, të cilat kanë mundësuar plotësisht pagesën e shumës 115.000 euro në shtator të vitit 2007 (konvertuar në atë periudhë në shumën prej rreth 14.000.000 lekësh). Ky konkluzion vjen në përputhje me qëndrimin e konsoliduar të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në rastet e

trupi gjykues çmoi se mundësia e kursimit të familjes Ç. do të duhet të përllogaritet sipas metodologjisë së referuar nga jurisprudenca e Kolegjit, në raste të ngjashme³², sipas së cilës: *Kolegji vlerëson se nuk do të ishte realiste dhe e arsyeshme një analizë e kryer për personin tjetër të lidhur pa verifikuar, ndërkohë, nëse familja e tij ka pasur mundësi së paku për të mbuluar kostot e jetesës, për më tepër, kur pjesë e të ardhurave, të cilat analizohen, janë ato që i përkasin të gjithë familjes, jo vetëm personit tjetër të lidhur si individ. Kryerja e analizës, duke konsideruar shpenzimet për jetesë për të gjithë familjen, në mungesë të konsiderimit si shpenzim të investimeve të tjera të kryera prej personit tjetër të lidhur, vlerësohet se përmbush nevojat e hetimit që lejojnë të shkohet drejt standardit kushtetues të justifikimit bindshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur.*

40. Në përfundim të vlerësimit të burimeve financiare të deklaruara dhe të ankimuar nga Komisionerja Publike në ankim, analiza sintetike e të ardhurave të familjes Ç. të pasqyruar nga Komisioni në vendim³³, u korrektova nga trupi gjykues duke mospërfshirë si të ligjshme të ardhurat të pretenduara të përfituara nga puna e personit të lidhur si përkthyes në shërbim të organizatave ndërkombëtare dhe nga puna si asistente mjeke promovimi pranë shoqërisë “{****}” ShPK në periudhën 2002-2005, si dhe konsiderimit dhe përfshirjes së të ardhurave të përfituara nga familja Ç. nga tregtimi i bimëve medicinale në shumën 1.687.450 lekë, duke rezultuar të ardhurat, në total, në shumën 12.229.218 lekë. Duke zbritur nga këto të ardhura që plotësonin kushtin e të ardhurave të ligjshme sipas parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, shpenzimet e jetesës të përllogaritura sipas jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, trupi gjykues arriti në përfundimin se personi i lidhur dhe prindërit e saj kanë qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në shumën (-) 5.807.452 lekë për kryerjen e plotë të pagesës për blerjen e pasurisë objekt kontrolli në shumën 13.800.000 lekë, për rrjedhojë subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
41. Në lidhje me shkakun e ankimit të Komisioneres Publike, sipas të cilit *për likuiditetet në cash në shumën 1.000.000 lekë, konkluzioni i arritur nga Komisioni nuk gjen referencë në dispozitat kushtetuese e ligjore apo në një vlerësim të drejtë të provave dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit*, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si më poshtë.
- 41.1. Komisioni, në vendim³⁴, lidhur me likuiditetet në *cash* në shumën 1.000.000 lekë të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka arsyetuar se deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së interesave të vitit 2011, shuma prej 4.446.000 lekësh e

kërkesës së provueshmërisë së të ardhurave për dhurimet apo huat nga personat e tjerë të lidhur, duke u çmuar se edhe në këtë rast është më se e mjaftueshme provueshmëria e përfitimit të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në shtator të vitit 2007, duke supozuar se nga tërësia e të ardhurave të pretenduara, të ardhurat e tjera të referuara si të përfituara nga aktiviteti i ligjshëm, por të paprovuara plotësisht me dokumentacion justifikues ligjor (të ardhurat shtesë nga aktiviteti tregtar, ku përfshihet edhe ai i bimëve medicinale), mund të kenë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të tjera të familjes Ç., duke mos cenuar në vetvete ligjshmërinë e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën në fjalë”.

³² Vendimi i Kolegjit nr. 2 (JR)/2023.

³³ Tabela nr. 3, faqja 34 e vendimit të Komisionit.

³⁴ Paragrafi 25 i vendimit të Komisionit.

kthyer nga shoqëria “{***}” ShPK, ka qenë e disponuar në gjendje *cash* nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të. Në deklaratën e vitit 2012, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit depozitë në Credins Bank, në shumën 3.000.000 lekë, me burim të ardhurat e përfituara si rezultat i kthimit të shumës nga shoqëria “{***}” ShPK, por, rezulton se në këtë formular të deklarimit të pasurive, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi pakësim të pjesës së mbetur të shumës prej 4.446.000 lekësh, e cila dukej se ishte deklaruar si gjendje *cash* në vitin 2011, pavarësisht pasaktësisë së evidentuar në deklarimin e kësaj shume në këtë formular. Si rrjedhim, Komisioni ka vlerësuar se duket i pranueshëm dhe i mbështetur në dokumentacion ligjor provues, deklarimi dhe sqarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, mbi disponimin në *cash* në fund të vitit 2012, të pjesës së mbetur nga shuma e kthyer prej shoqërisë “{***}” ShPK, në janar të vitit 2012. Komisioni ka arritur në konkluzionin se në fund të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë disponuar shumën prej rreth 1.5 milion lekësh në gjendje *cash*, me burim të ardhurat e kthyer nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, në janar të vitit 2012. Sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për shtesa të likuiditeteve *cash* përgjatë viteve 2013 - 2015, Komisioni ka çmuar se ato mbeten të karakterit deklarativ dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare është vlerësuar se si burim për mbulimin e shpenzimeve shtesë të arredimit/mobilimit të kryera në vitin 2016 dhe disponimin e gjendjes *cash* në fund të këtij viti, në shumën prej 1 milion lekësh, mund të kenë shërbyer kursimet në formë likuiditetesh *cash* në shumën prej rreth 1.5 milion lekësh, vlerësuar si gjendje likuiditetesh *cash* në fund të vitit 2012 dhe të padeklaruara si të pakësuara në deklaratat vijuese të pasurisë përpara vitit 2016, si dhe vlerat e mundshme të kursyera prej të ardhurave nga paga e subjektit dhe e personit të lidhur për vitin 2016 (apo të ardhura të tjera të evidentuara gjatë këtij viti). Nga analiza e treguesve financiarë e kryer për periudhën 01.01.2016 - 31.12.2016, nga rezultati pozitiv i së cilës në shumën 275.085 lekë, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë vetëdeklaruar kursime të likuiditeteve *cash* deri në datën 31.12.2015, dhe kanë realizuar të ardhura për vitin 2016, të krijuara nga burime financiare të ligjshme, të cilat rezulton se mundësojnë plotësisht krijimin dhe disponimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën 1.000.000 lekë, në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit kalimtar.

41.2. Komisionerja Publike, në ankim, ka kundërshtuar si të pabazuar arsyetimin dhe konkluzionin e mësipërm të Komisionit, duke argumentuar se:

(i) në deklaratat periodike vjetore 2006-2015, subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur nuk kanë deklaruar shtesa apo pakësime të likuiditeteve në *cash*, për rrjedhojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi disponimin e likuiditetit *cash* në shumën 1.500.000 lekë në fund të vitit 2012, mbetet i pabazuar dhe në nivel deklarativ;

(ii) këto kursime të pretenduara të padeklaruara, nuk mund të kenë shërbyer si burim të ardhurash të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve të arredimit dhe krijimit të likuiditeteve në *cash*, në shumën 1.000.000 lekë, në fund të vitit 2016. Nëse në analizën e treguesve financiarë të vitit 2016, nuk përfshihen likuiditetet në *cash* të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, si të mbartura nga viti 2015, atëherë subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjaftueshmëri financiare në shumën rreth (-) 1.200.000 lekë, për vitin 2016;

(iii) përveçse këto kursime në *cash* nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore, që shërbejnë si provë në këtë proces, edhe burimi i pretenduar për to, nga shuma 4.446.000 lekë, nuk mbulohet me burime të ligjshme, referuar qëndrimit të mbajtur në ankim, lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të kësaj shume.

41.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime konfirmoi pretendimet e Komisioneres Publike, lidhur me likuiditetet në *cash*. Në shtim të këtyre pretendimeve, lidhur me shumën prej 4.446.000 lekësh, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në vijim të gjetjes/opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar, në konkluzionet përfundimtare, parashtrori se lidhur me arsyet e kthimit të kësaj shume, konstaton se:

(i) Kjo shumë është deklaruar prej subjektit si e prejardhur nga marrëdhënia me shoqërinë “{***}” ShPK për apartamentin, me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}” Tiranë dhe përbën rreth 30% të vlerës së apartamentit;

(ii) Në deklaratën e interesave të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga kjo shumë ka investuar 3.000.000 lekë, në çeljen e një depozite me afat, në Credins Bank, për të cilën deklaroi pjesë takuese 100%;

(iii) Rezulton se diferenca ndërmjet çmimit të paguar në vitin 2007 prej 13.800.000 lekësh, sipas kontratës së sipërmarrjes dhe atij prej 11.700.000 lekësh të përcaktuar në kontratën e shitblerjes në vitin 2012 është 2.100.000 lekë dhe jo 4.446.000 lekë, sa pretendon subjekti i rivlerësimit;

(iv) Pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me vonesën në dorëzimin e apartamentit, ndryshimin e sipërfaqes, cilësinë e punimeve dhe materialeve, si dhe me punimet e pakryera, nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara dhe mbeten në nivel deklarativ.

Në përfundim, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për shumën 4.446.000 lekë të përfituar gjatë martesës dhe gjatë ushtrimit të detyrës, e cila është deklaruar si e përfituar nga shoqëria “{***}” ShPK dhe më pas deklarohet si një nga burimet e krijimit për depozitën bankare në emër të subjektit të rivlerësimit në Credins Bank.

41.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, në prapësimin e shkakut të ankimit ka mbajtur qëndrim të njëjtë si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur se për efekt të ligjit nr. 84/2016, objekt kontrolli dhe verifikimi është vetëm saktësia dhe vërtetësia e të dhënave të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, prandaj çdo vlerësim duhet të përqendrohet në legjitimitetin e burimit të shumës prej 4.446.000 lekësh dhe jo në ekzistencën ose jo të saj në formularë të mëparshëm periodikë, të cilët nuk janë objekt vlerësimi substancial në kuptimin e dispozitave të ligjit për rivlerësimin. Sipas rendit kronologjik dhe logjik të zhvillimeve të mbështetura në dokumentacionin përkatës të administruar gjatë hetimit administrativ, rezulton se pasuria “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë”, ishte porositur që në shtator të vitit 2007, përpara lidhjes së martesës dhe fillimit të bashkëjetesës dhe në kontratën e shitblerjes së vitit 2012 është përcaktuar çmimi përfundimtar i pasurisë në shumën 11.700.000

lekë. Ky çmim rezulton më i ulët sesa vlera e paguar më herët, për shkak se shoqëria kishte pranuar zbritje të tij si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve të saj, përfshirë dorëzimin me vonesë, sipërfaqen më të vogël të apartamentit nga ajo e parashikuar, punime të papërfunduara dhe cilësi të ulët ndërtimi. Këto rrethana janë konfirmuar me deklaratë noteriale të përfaqësueses ligjore të shoqërisë, datë 20.04.2023, e cila është dorëzuar gjatë hetimit administrativ në Komision dhe nuk është kundërshtuar si provë nga Komisionerja Publike. Në vijim të kontratës së shitblerjes, shoqëria ka hartuar një deklaratë noteriale të veçantë me të cilën konfirmon kthimin e shumës prej 4.446.000 lekë në favor të blerësve, të referuar në kontratën e po asaj date. Shoqëria ka konfirmuar edhe më pas, me deklaratë noteriale të administratores, edhe kjo e dorëzuar në Komision, duke theksuar se shuma është kthyer *cash* në dorë dhe jo përmes sistemit bankar, në të njëjtën mënyrë si parapagimi i kryer në vitin 2007. Ky transaksion është deklaruar në vitin 2011, në deklaratën periodike të interesave. Shuma e kthyer nga shoqëria “{***}” ShPK, ka si burim kursimet personale të personit të lidhur dhe të prindërve të saj, ashtu si subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në prapësimet e shkaqeve përkatëse të ankimit, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m² në rrugën “{***}”, në Tiranë”, kursime që burojnë nga të ardhura të ligjshme. Kjo shumë është deklaruar gabimisht në deklaratën periodike të interesave të vitit 2011, pasi veprimi financiar ka ndodhur në fillim të vitit pasardhës 2012, për shkak të mungesës së qartësisë në udhëzuesin teknik të plotësimit të formularit përkatës. Në këtë kontekst, shuma e përfituar nga kthimi i shumës së paguar më parë për blerjen e apartamentit është deklaruar si shtim i likuiditetit përmes një pakësimi të një pasurie tjetër të mëparshme (vlera e apartamentit). Edhe po të ishte kryer në vitin 2012, deklarimi do të ishte në të njëjtën formë, pasi formularët nuk parashikonin rubrikë të veçantë për pasqyrimin e gjendje në *cash*. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në deklaratën e interesave të vitit 2012, ka deklaruar pakësimin e gjendjes në *cash* të deklaruar në vitin 2011 në shumën 4.446.000 lekë, si dhe depozitimin e një pjese të kësaj shume pranë Credins Bank, më datë 25.05.2013. Pas kryerjes së depozitimit në bankë, subjekti i rivlerësimit ka vijuar të disponojë në *cash*, shumën prej 1.446.000 lekësh, për të cilën nuk ka bërë deklaram të veçantë në deklaratën e vitit 2012, për shkak se, në mirëbesim ka konsideruar këtë vlerë tashmë si të deklaruar që prej janarit 2012, moment në të cilin kjo shumë ka dalë nga pasuria e paluajtshme (apartamenti) dhe është kthyer në formë likuiditeti nga shoqëria “{***}” ShPK. Për rrjedhojë, mosdeklarimi i shumës prej 1.446.000 lekësh si gjendje *cash* në vitin 2012, nuk përbën mospërputhje materiale apo shkelje të detyrimeve të deklarimit, por ka ardhur si pasojë e faktit se vetë formulari nuk e parashikonte këtë veçim. Shuma prej 1.446.000 lekësh është bashkuar me kursimet e tjera të vitit 2016 dhe është pasqyruar në deklaratën e interesave të vitit 2016. Kjo shumë është deklaruar me përshkrimin gjendje në *cash* në shumën 1.000.000 lekë, pas pakësimit për qëllim mobilimi në shumën 1.000.000 lekë, veprim i cili gjithashtu është reflektuar në dokumentacionin përkatës, duke saktësuar dhe burimin e krijimit të kësaj vlere. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se analiza financiare e kryer nga Komisioni, në të cilën rezulton se familja e tij ka një bilanc pozitiv në vlerën 275.085 lekë për vitin 2016, duhet të mbetet e pandryshuar, për sa kohë të ardhurat kanë qenë të provuara dhe të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe investimet e kryera gjatë vitit përkatës, pa rezultuar asnjë mospërputhje materiale e paprovuar në burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë.

42. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstatoi si vijon.

42.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: *“Gjendje cash, në vlerën 1.000.000 lekë; pjesa takuese: 50%+50 % me bashkëshorten. Burimi i krijimit: Nga kursimet familjare të pagave”*.

42.2. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar më datë 24.03.2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash* në shumën 400.000 lekë, nga të ardhurat nga puna si jurist pranë parkut urban të udhëtarëve, bashkia Tiranë dhe nga puna me kohë të pjesshme (*part-time*).

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Shuma prej 400.000 lekësh e pohuar në deklaratën fillestare të pasurisë ka qenë disponuar në gjendje cash para fillimit të punës si gjyqtar. Burimi i krijimit të kësaj shume ishin të ardhurat e referuara në këtë deklaratë. Sqarohet se brenda viteve, kjo gjendje cash është përdorur dhe gjithashtu është zëvendësuar. Për shembull, në qershor 2007, është përdorur gjendja cash për plotësimin e shumës 1.000.000 lekë të çeljes së depozitës pranë Intesa San Paolo Bank dhe po brenda muajve korrik-dhjetor po të vitit 2007, është plotësuar me burim krijimi nga të ardhurat nga pagat dhe mësimdhënia në universitetin “{***}”*.

42.3. Për periudhën 2007-2010, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa apo pakësime të likuiditeteve në *cash*, në deklaratimet periodike vjetore të interesave.

42.4. Në deklaratën e interesave private të vitit 2011, në seksionin “Deklarimi i interesave private pasuritë e paluajtshme/pasuritë e luajtshme”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2012, e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, z. V. C., për kthim shume lekësh si diferencë midis vlerës së kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2007, të lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK sipërmarrësi dhe A. Ç. porositi dhe kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2012, lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK shitësi dhe A. P. e Ervin Pollozhani blerësit, shuma prej 4.446.000 lekësh.*

Lidhur me deklarinimin e kësaj shume në deklaratën e këtij viti, në një kohë kur dokumenti mban datën 20.01.2012, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, ka deklaruar: *“Shuma prej 4.446.000 lekë e kthyer nga shoqëria “{***}” ShPK në janar të vitit 2012, pra brenda marsit të vitit 2012, kur edhe bëhet deklarimi për vitin pasardhës, është deklaruar si e tillë me gjithë specifikimet përkatëse që në DPV-në e vitit 2011 [...].*

Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2012, administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, ka deklaruar se: *“[...] sot, më datë 20.01.2012, i kam kthyer znj. A. P., si dhe bashkëshortit të saj Ervin Pollozhani, shumën prej 4.446.000 lekësh, si diferencë midis çmimit të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2007, të lidhur midis A. Ç. (P.) dhe shoqërisë “{***}” ShPK me çmimin e paguar realisht, sipas kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2012, për një pasuri të paluajtshme që*

*konsiston në apartamentin [...] me sipërfaqe 97,5 m² në rrugën “{***}”. Kjo shumë është likuiduar plotësisht me para në dorë, përpara përpilimit të kësaj kontrate, jashtë zyrës noteriale.*

42.5. Në deklaratën e interesave private që i përket vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar krijimin e depozitës me afat 1 vjeçar, në Credins Bank, në datë 25.05.2012, në shumën 3.000.000 lekë, me burim krijimi: *“Depozitë që rrjedh nga të ardhurat e përfituara nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2012”.*

42.6. Në deklaratën e interesave private të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndryshime të gjendjes së kursimeve në *cash*. Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar: a) çeljen e depozitës bankare në Credins Bank, më datë 27.05.2013, në shumën 3.177.905 lekë, e cila derivon nga depozita e mëparshme e çelur në të njëjtën bankë, në datë 25.05.2012 në shumën 3.000.000 lekë, si dhe interesat bankare mbi këtë depozitë, në shumën 177.905 lekë; b) çeljen e depozitës bankare në Credins Bank, më datë 01.10.2013, në shumën 1.500.000 lekë, e cila derivon nga depozita e mëparshme e çelur në Intesa Sanpaolo Bank në vitin 2008, në shumën 1.383.906 lekë plus shtesë nga të ardhurat nga pagat vjetore.

42.7. Në deklaratën e interesave private të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndryshime të gjendjes së kursimeve në *cash*.

42.8. Në deklaratën e interesave private të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shpenzime të kryera për arredimin e apartamenti të blerë me kontratën e shitblerjes (paraprake) nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 22.09.2014. Vlera: 400.000 lekë, vlerë e shpenzuar nga kursimet familjare.*

42.9. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: *“Gjendje cash, në vlerën 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%+50 % me bashkëshorten. Burimi i krijimit: Nga kursimet familjare të pagave; si dhe: arredimi i banesës 1.000.000 lekë nga pakësimi i gjendjes cash të akumuluar në vite nga kursimet familjare”.*

Në deklaratën e interesave private të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: *“Gjendje cash. Vlera: 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%+ 50% me bashkëshorten. Burimi i krijimit: Nga kursimet familjare ndër vite të pagave personale dhe të bashkëshortes”.*

Në të njëjtën deklaratë, personi i lidhur, bashkëshortja ka deklaruar: *“Arredimi i banesës nga pakësimi në vitin 2016 i gjendjes cash të akumuluar në vite. Vlera: 1.000.000 lekë”.*

43. Trupi gjykues, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, për sa i përket shkakut të ankimit lidhur me pasurinë “likuiditetet *cash*”, pasi u njoh me kërkimet përfundimtare të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me shpjegimet dhe prapësimet e dhëna lidhur me to nga subjekti i rivlerësimit, analizoi sa vijon.

43.1. Për sa i përket shumës prej 4.446.000 lekësh, kthyer bashkëshortëve P. nga shoqëria “{***}” ShPK, si diferencë mes çmimit të paguar sipas kontratës së sipërmarrjes të vitit 2007³⁵ dhe çmimit të paguar sipas kontratës së shitjes së vitit 2012³⁶, trupi gjykues konstatoi se referuar pretendimeve të parashtruara në ankim, nga Komisionerja Publike nuk është vënë në dyshim përfitimi i kësaj shume, por vetëm është kundërshtuar ekzistenca e saj si likuiditet *cash*, për shkak të mungesës së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në fund të vitit 2012, si dhe mosjustifikimi i saj me burime të ligjshme, për sa kohë që në ankim është pretenduar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provojnë mbulimin me burime të ligjshme të pasurisë “apartament” në rrugën “{***}”, Tiranë.

Sa më sipër, trupi gjykues çmoi se në ankimin e Komisioneres Publike nuk është ngritur shkak ankimi apo ndonjë pretendim, lidhur me besueshmërinë e përfitimit të shumës prej 4.446.000 lekësh, të kthyer nga shoqëria “{***}” SHPK prej çmimit të paguar për blerjen e apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, e cila më pas deklarohet si një nga burimet e krijimit për depozitën bankare në shumën 3.000.000 lekë, në emër të subjektit të rivlerësimit, në Credins Bank.

Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se lidhur me dyshimin mbi besueshmërinë e kthimit të shumës prej 4.446.000 lekësh si më sipërcituar, ankuesi ka humbur mundësinë/afatin për ngritjen e këtij shkak në Kolegj. Parashtrimi i këtij pretendimi nga ankuesi, duke marrë shkas nga gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar, vetëm në fazën e bisedimeve përfundimtare, bazuar edhe në arsyetimin në paragrafët 14 dhe 15 më sipër në këtë vendim, nuk mund t’i nënshtrohet shqyrtimit për vendimmarrje në Kolegj, në zbatim të neneve 6 dhe 465, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile, pasi vlerësohet se është një pretendim jashtë shkaqeve të ankimit.

43.2. Referuar shkaqeve të ankimit të Komisioneres Publike, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në seksionin “Deklarimi i interesave private pasuritë e paluajtshme/pasuritë e luajtshme”, të deklaratës së interesave të vitit 2011, ka deklaruar kthimin e shumës prej 4.446.000 lekësh nga shoqëria “{***}” ShPK, në datë 20.01.2012, si ndryshim/shitesë e pasurisë “likuiditet”, gjendje në janar të vitit 2012. Deklarimi i kësaj shume në deklaratën e interesave të vitit 2011, përbën një pasaktësi në deklarim, pasi kjo shumë duhet të deklarohej nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e vitit 2012, në zbatim të parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar. Pavarësisht nga pasaktësia e evidentuar si më sipër, në kushtet kur deklarata e interesave private e vitit 2011 mban si datë dorëzimi datën 23.03.2012, dhe shuma prej 4.446.000 lekësh ishte kthyer në datën 20.01.2012, trupi gjykues vlerësoi të pranueshme dhe të besueshme logjikën e subjektit të rivlerësimit në deklarimin e kësaj shume në formularin e vitit 2011 dhe jo në atë të vitit pasardhës, çka dëshmon jo për një veprim të qëllimshëm, por për një mënyrë të perceptuarit të tillë të plotësimit prej tij të formularit.

Nga verifikimi i akteve të administruara në fashikull, trupit gjykues nuk i rezultoi që kjo pasuri “likuiditet” deri në momentin e depozitimit të deklaratës së interesave të vitit 2011 të ishte

³⁵ Kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2007, të lidhur midis shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK dhe znj. A. Ç. si palë porositëse.

³⁶ Kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2012, të lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK në cilësinë e shitësit dhe A. e Ervin Pollozhani në cilësinë e blerësit.

depozituar në një institucion bankar, për rrjedhojë vlerësoi se ajo ishte pasuri “likuiditet” e disponuar në *cash* nga subjekti i rivlerësimit. Në deklarinimin e interesave private të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë “depozitë në Credins Bank ” me vlerë 3.000.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga shuma prej 4.446.000 lekësh, burim ky i konfirmuar edhe në deklaratën e rivlerësimit. Trupi gjykues vlerësoi se nëpërmjet këtij deklarimi, subjekti i rivlerësimit edhe pse nuk ka deklaruar sipas detyrimit ligjor pakësimin e pasurisë “likuiditet *cash*” të deklaruar në deklaratën e interesave të vitit 2011, ai ka kryer deklarim vetëm për atë pjesë të pasurisë “likuiditet” për të cilën kishte ndryshuar forma e disponimit nga likuiditet *cash* në likuiditet bankar. Nëpërmjet këtij deklarimi në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka pakësuar pasurinë “likuiditet në *cash*” me shumën e depozituar në bankë, ndërkohë që pjesa tjetër prej 1.446.000 lekësh ([si diferencë midis shumës 4.446.000 lekë dhe shumës 3.000.000 lekë nga çelja e depozitës bankare]), disponohej prej tij në të njëjtën formë, në *cash*, ashtu siç ajo ishte deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2011.

Përveç sa më sipër, në kushtet kur: (i) në seksionin përkatës në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesë të pasurisë “likuiditet *cash*” mbi vlerën 1.446.000 lekë; (ii) nuk ka deklaruar shpenzime të kryera në vlerën mbi 5 00.000 lekë; (iii) si dhe nga verifikimi i periudhës 25.05.2012-31.12.2012 nuk u evidentua kryerja e shpenzimeve të tjera që do të justifikonin shpenzimin e shumës së mbetur si pasuri “likuiditet *cash*”, trupi gjykues vlerësoi se kjo shumë ka vijuar të disponohet nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur si gjendje *cash* në fund të vitit 2012. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin se në deklaratat e interesave private ndër vite, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar specifikisht pakësimin e kursimeve në *cash*, por ka deklaruar vetëm përdorimin e tyre si burim për krijimin e pasurive apo shpenzimeve të kryera prej tij.

43.3. Për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë objekt kontrolli, në vijim të konkluzionit të arritur në paragrafin 40 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerësoi se shuma prej 4.446.000 lekësh plotëson kushtet për t’u konsideruar si e ardhur e ligjshme, si pjesë e burimeve financiare që personi i lidhur dhe prindërit e saj kishin mundësi të krijonin me të ardhura të ligjshme, të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}” në Tiranë”. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi si të ardhur të ligjshme edhe shumën prej 1.446.000 lekësh të mbetur si likuiditet në *cash*, (pas depozitimit në llogari bankare të shumës prej 3.000.000 lekësh), në fund të vitit 2012, e mbartur deri në fillim të vitit 2015. Kjo shumë, së bashku me kursimet *cash* nga pagat në shumën 400.000 lekë të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006³⁷, në total në vlerën 1.846.000 lekë, disponohej si likuiditet *cash* nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në fillim të vitit 2015. Trupi gjykues, nga analiza e deklarimeve në deklaratën

³⁷ Në interpretim të deklarinimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar më datë 24.03.2006, se dispononte kursime në *cash* në shumën 400.000 lekë, në raport me faktin se nga verifikimi i deklarimeve periodike të interesave në vitet në vijim, nuk ka deklaruar ndryshime të kursimeve në *cash*, trupi gjykues, objektivisht, vlerësoi se shuma prej 400.000 lekësh është përcjellë si gjendje *cash* edhe në vitet në vijim, pasi subjekti i rivlerësimit, në referim të shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, e ka përdorur dhe zëvendësuar këtë shumë brenda vitit financiar, duke mos ndikuar në ndryshimin e gjendjes së saj në fund të çdo viti.

e interesave të vitit 2015, vlerësoi se nga shuma prej 1.846.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka përdorur vlerën prej 400.000 lekësh për shpenzimet e mobilimit të kryera në vitin 2015³⁸. Për rrjedhojë, në fillim të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur dispononin likuiditet *cash* në vlerën 1.446.000 lekë, nga e cila shuma prej 1.046.000 lekësh ishte e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e mobilimit në vlerën 1.000.000 lekë të deklaruara si të mbuluara me kursimet familjare në deklaratën e interesave të vitit 2016 e në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke mbetur e papërdorur si likuiditet *cash*, shuma prej 400.000 lekësh krijuar nga pagat, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, në vitin 2006.

43.4. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues verifikoi edhe mundësinë për të krijuar pasurinë “likuiditet *cash*” në vlerën 1.000.000 lekë, referuar burimeve të deklaruara nga subjekti për krijimin e saj si kurse familjare nga pagat, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit e në deklaratën e interesave private të vitit 2016. Nga analiza e kryer në Kolegj, duke mbajtur në konsideratë kursimet *cash* në shumën 400.000 lekë, të deklaruara me burim nga pagat në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2006, të mbartura deri në fillim të vitit 2016, sipas analizës në paragrafin 43.3 më sipër në këtë vendim, si dhe kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes për vitin 2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kishin mundësi të krijojnë me të ardhura nga burime të ligjshme pasurinë “likuiditetet *cash*” në vlerën 1.000.000 lekë.

44. Në konkluzion, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme, të cilat mundësonin plotësisht krijimin dhe disponimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën 1.000.000 lekë, në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, duke u gjetur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
45. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me shpenzimet e mobilimit për apartamentet në pronësi të tij*, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si më poshtë.

45.1. Komisionerja Publike, në argumentimin e këtij shkakui ankimi, ka pretenduar se:

45.2. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me shpenzimet e mobilimit, pasi në deklaratën e rivlerësimit ka deklaruar shpenzime mobilimi në vlerën 1.000.000 lekë dhe 10.000 euro, ndërsa në deklaratat periodike vjetore dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, ka

³⁸ Në deklaratën e interesave private të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar: Shpenzime të kryera për arredimin e apartamentit të blerë me kontratën e shitblerjes (paraprake) nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 22.09.2014. Vlera: 400.000 lekë, vlerë e shpenzuar nga kursimet familjare. Shpenzime të kryera për arredimin e apartamentit të blerë me kontratën e shitblerjes (paraprake) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2014. Vlera 10.336 euro, vlerë e përdorur si shumë totale e përfituar nga: a) diferenca e përfituar nga çmimi i shitjes së apartamentit me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.2014, (10.000 euro tërhequr nga banka në datë 28.09.2015); si dhe b) interesat e përfituara nga depozita bankare [...] pranë Credins Bank [...] (336 euro).

deklaruar shpenzime mobilimi në vlerën 400.000 lekë dhe 10.336 euro, në vitin 2015 dhe 1.000.000 lekë, në vitin 2016.;

45.3. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me shpenzimet e mobilimit të apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, pasi ka deklaruar vlera dhe burime të ndryshme lidhur me këto shpenzime. Konkretisht, në procesverbalin e ILDKPKI-së, ka deklaruar si burim ndihma të dhëna nga familja e bashkëshortes dhe familja e tij, ndërsa gjatë hetimit administrativ në Komision deklaroi si burim dhe të ardhurat e bashkëshortëve Pollozhani, duke mbetur kështu e paqartë se cili prej deklarameve të subjektit paraqet saktë situatën faktike. Referuar deklaramave periodike vjetore për periudhën 2008-2010, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur të kenë deklaruar ndihma/dhurime nga familjarët e tyre.;

45.4. Lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të këtyre shpenzimeve, bazuar në deklaramet e subjektit të rivlerësimit, rezultoi se shpenzimi në shumën 10.336 euro, në vitin 2015, ka si burim krijimi të ardhurat nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 95,7 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, ndërsa shpenzimet në shumën 1.000.000 lekë në vitin 2016 kanë si burim krijimi pakësimin e kursimeve *cash*. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provojnë mbulimin me burime të ligjshme të apartamentit me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë, çka afekton dhe ligjshmërinë e shumës 10.336 euro, deklaruar si burim krijimi për arredimin e vitit 2016. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kursimet *cash* ndër vite, si rezultat dhe deklaram të pamjaftueshëm lidhur me shpenzimet e mobilimit në shumën 1.000.000 lekë, në vitin 2016.

45.5. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, ndau të njëjtin qëndrim me shkakun e ankimit të Komisioneres Publike, duke vlerësuar se edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me shpenzimet e mobilimit për apartamentet në pronësi të tij.

45.6. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e këtij shkakun ankimi, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, ka parashtruar se edhe pse në deklaramen e rivlerësimit ka pasqyruar shpenzimet për mobilimin e apartamentit në vlerën 10.000 euro dhe 1.000.000 lekë, së bashku me burimet përkatëse të krijimit të tyre, nuk ka përfshirë specifikisht shpenzimin e kryer për mobilim në vitin 2015 në vlerën 400.000 lekë, edhe pse kjo shumë është deklaruar qartësisht prej tij në deklaramen e interesave private të vitit 2015. Kjo mospërfshirje në deklaramen e rivlerësimit ka ndodhur për arsye harrese pa pasur ndonjë qëllim për të shmangur deklaramin apo për të ndryshuar pasqyrën reale të shpenzimeve. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo pasaktësi formale nuk ka ndikim as në analizën financiare të periudhës, për sa kohë shpenzimi është deklaruar në mënyrë të rregullt në deklaramen e interesave private të vitit 2015 dhe është marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të tepricës së të ardhurave për këtë vit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ka pasur teprica të konsiderueshme të të ardhurave gjatë viteve në fjalë, të mjaftueshme për të përballuar edhe shpenzimet e mobilimit të dy apartamenteve, të cilat janë deklaruar në mënyrë të plotë e të sinqertë si në deklaramat përkatëse, ashtu edhe në pyetësorin standard të drejtuar nga Komisioni. Shpjegimet

lidhur me këto shpenzime, janë dhënë prej tij në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe janë paraqitur për herë të parë në përgjigje të pyetjeve të ngritura në kuadër të këtij procesi, për të cilat nuk ka ekzistuar më parë as ndonjë detyrim formal për saktësim të tillë dhe as ndonjë kërkesë për trajtim përpara nisjes së procesit të rivlerësimit. Pretendimi i Komisioneres Publike se shpenzimet e mobilimit nuk janë deklaruar në formularët periodikë të para vitit 2012 është i pabazuar në ligj, pasi për ato vite nuk ekzistonte një detyrim deklarues për shpenzime të tilla, qoftë sipas përmbajtjes së formularëve të deklaratave të interesave private, qoftë sipas ligjit në fuqi në atë kohë.

46. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut të ankimit, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstatoi se lidhur me shpenzimet e mobilimit të pasurive të paluajtshme të ndodhura në Tiranë, “apartament në rrugën “{***}”” dhe “apartament në rrugën “{***}””, nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, është deklaruar si vijon.

46.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit: *“Arredim i banesës 1.000.000 lekë, nga pakësimi në vitin 2016 i gjendjes cash të akumuluar në vite nga kursimet familjare + 10.000 euro tërhequr në datën 28.09.2015, si rezultat i përfundimit të Kontratës së depozitës me afat pranë Credins Bank, datë 22.09.2014”.*

46.2. Në deklaratën e interesave të vitit 2015: *“Shpenzime të kryera për arredimin e apartamentit të blerë me kontratën e shitblerjes (paraprake) nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 22.09.2014. Vlera: 400.000 lekë, vlerë e shpenzuar nga kursimet familjare”.*

*Shpenzime të kryera për arredimin e apartamentit të blerë me kontratën e shitblerjes (paraprake) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2014. Vlera 10.336 euro me burim krijimi: (i) diferencën e përfutur nga çmimi i shitjes së apartamentit me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.2014 (10.000 euro, tërhequr nga banka në datën 28.09.2015), si dhe interesat e përfutuara nga depozita bankare”.*

46.3. Në përgjigjet e pyetësorit standard të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar shpenzimet e kryera për mobilimin e apartamenteve, sipas të dhënave të deklaruara në formularët përkatës, si më sipërcituar, duke detajuar se për herë të parë, ka arreduar në muajt maj-qershor 2008, dhomën e tij të gjumit në apartamentin në bashkëpronësi të prindërve në rrugën “{***}”, Tiranë, në vlerën 180.000 lekë, blerë pranë mobileri “{***}” SHPK, Tiranë. Për këtë blerje, për kohën e gjatë të saj, nuk disponon faturë. Në vitin 2009, po në këtë pronë, subjekti i rivlerësimit ka blerë pranë “{***}” ShPK dhe një televizor + frigorifer, në vlerën 130.000 lekë, për të cilën nuk disponon faturë. Këto të gjitha u transferuan në muajin prill 2010, në apartamentin në rrugën “{***}”, Tiranë. Në muajt nëntor-dhjetor 2009, u ble dhe u montua kundërbufeja në apartamentin e porositur në rrugën “{***}”, në shumën 96.000 lekë, blerë pranë mobileri “{***}” ShPK, Tiranë dhe në muajt prill-maj 2010 u plotësua arredimi në këtë apartament, në shumën 180.000 lekë, blerë pranë së njëjtës mobileri, blerje për të cilat nuk disponon fatura. Ndërsa vlera e kostos së arredimeve për apartamentin në rrugën “{***}”, është sipas deklarimeve periodike: 400.000 lekë (DPV- 2015); 10.336 euro (DPV- 2015); 1.000.000 lekë 2016.

47. Në analizë të pretendimit të Komisioneres Publike, në ankim, se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me vlerën/shumën e shpenzimeve të mobilimit për pasurinë “apartament në rrugën “{***}””, pasi në deklaratën e rivlerësimit deklarohet shpenzime mobilimi në vlerën 1.000.000 lekë dhe 10.000 euro, ndërsa në deklaratat periodike vjetore dhe gjatë hetimit administrativ deklarohen shpenzime mobilimi në vlerën 400.000 lekë dhe 10.336 euro në vitin 2015 dhe 1.000.000 lekë në vitin 2016, trupi gjykues vëren se ndonëse konstatimi i mësipërm është i drejtë, referuar rubrikave të formularit të deklaramit të pasurisë së rivlerësimit sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrimin për deklaramin e shpenzimeve të mobilimit, apo të ndonjë shpenzimi tjetër të kësaj kategorie. Në këto kushte, në ndryshim nga sa ka pretenduar Komisionerja Publike, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për deklaram të pasaktë të këtyre shpenzimeve në deklaratën e pasurisë rivlerësimit, të cilat janë deklaruar në mënyrë vullnetare dhe jo në kuadër të një detyrimi ligjor.

47.1. Lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të këtyre shpenzimeve, trupi gjykues mbajti në konsideratë konkluzionin e arritur më sipër në këtë vendim se në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit kishte të ardhura të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e mobilimit në vlerën 1.000.000 lekë.

Sa i takon shumës prej 10.336 eurosh, deklaruar nga personi i lidhur si shpenzime mobilimi për apartamentin në rrugën “{***}” Tiranë, të kryera në vitin 2015, të mbuluara nga vlera e shitjes së apartamentit në rrugën “{***}” në Tiranë³⁹, referuar burimit të krijimit, trupi gjykues vlerësoi se kjo shumë është e mbuluar nga burime të ligjshme, si pjesë e burimeve financiare që personi i lidhur dhe prindërit e saj kishin mundësi të krijojnë me të ardhura të ligjshme, të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m²”, në rrugën “{***}” në Tiranë.

48. Lidhur me shpenzimet e mobilimit të apartamentit të sipërcituar, trupi gjykues konstatoi si vijon:

48.1. Shpenzimet e mobilimit të pasurisë “apartament në rrugën “{***}” Tiranë” janë kryer në periudhën 2008-2010 dhe në këtë periudhë kohore, ky lloj shpenzimi nuk deklarohet në formularët përkatës të deklaramit të interesave private⁴⁰. Në këtë kontekst, subjekti i rivlerësimit, në përputhje me parashikimet ligjore dhe formularët e deklaramit, nuk ka deklaruar shpenzime mobilimi për pasurinë në fjalë, në deklarimet periodike të interesave.

48.2. Mospërputhjet në deklaramin e këtyre shpenzimeve janë evidentuar përtej deklarimeve periodike të interesave dhe referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit kanë ardhur jo me qëllim të paraqitjes së një situatë të rreme, por duket se kanë rrjedhur nga një perceptim i ndryshëm

³⁹ Si diferencë e përfutur nga çmimi i shitjes së apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, në shumën 130.000 euro me vlerën e pagesës së kështit për blerjen e apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, në shumën 108.000 euro.

⁴⁰ Detyrimi për deklaramin i këtij lloji është parashikuar më vonë në kohë, me ndryshimet që iu bënë ligjit nr. 9049/2003, në vitin 2012, me anë të ligjit amendues nr. 85/2012.

Në nenin 3 të ligjit nr. 85/2012 parashikohet se: Në nenin 4 ([të ligjit nr. 9049/2003]) bëhen ndryshimet dhe shitesat e mëposhtme: [...] 3. Pas shkronjës “ë” shtohen shkronjat “f”, “g”, “gj” dhe “h” me këtë përmbajtje: [...] h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 500.000 (pesëqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklaramit. ”. Sipas nenit 1 të po këtij ligji, në përkufizimet e ligjit nr. 9049/2003, shtohet dhe: “7. “Shpenzim i deklarueshëm” është tërësia monetare, e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues.”

i tij lidhur me gamën e shpenzimeve për t'u deklaruar.

48.3. Në konsideratë të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se mospërputhja e deklaruar në vlerat e shpenzimeve të mobilimit dhe burimeve të deklaruara për mbulimin e tyre, gjatë hetimit administrativ në Komision në raport me deklarin në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2014, nuk ka dhënë asnjë pasojë në kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, pasi në analizën financiare të kryer nga Komisioni, këto shpenzime janë përlllogaritur në vlerën më të lartë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, kjo rrethanë nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit edhe me kualifikimin e një deklarimi të pasaktë lidhur me këto shpenzime, qoftë edhe në deklarinet gjatë hetimit administrativ në Komision, për sa kohë subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kishin burime financiare të ligjshme për përballimin e tyre.

- 49.** Në mbështetje të konkluzioneve të mësipërme, lidhur me kontrollin e kriterit të vlerësimit të pasurisë, e vetmja problematikë mbetet ajo e mungesës së të ardhurave të ligjshme për kryerjen e plotë të pagesës për blerjen e pasurisë “apartament”, në rrugën “{***}”, në Tiranë, nga personi i lidhur dhe prindërit e saj.

Trupi gjykues, në vijim të analizës dhe arsyetimit, në paragrafin 40 në këtë vendim, arriti në përfundimin se problematika e konstatuar lidhur me burimet financiare të krijimit të pasurisë “apartament me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}”, në Tiranë, të ardhurat nga shitja e së cilës kanë shërbyer si burim financimi për blerjen e pasurisë “apartament me sipërfaqe 99,7 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë”, duhet vlerësuar në aplikim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit sipas parashikimit të nenit 4, pika 5 dhe nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi:

(i) në krijimin e kësaj pasurie nga personi i lidhur dhe prindërit e saj përpara lidhjes së martesës ligjore me subjektin e rivlerësimit, rezultoi e provuar se përjashtohet çdo lloj kontributi i subjektit të rivlerësimit;

(ii) për periudhën 1996-2007, mbajti në konsideratë se rrethanat në të cilat personi i lidhur dhe prindërit e saj kanë ushtruar aktivitetin tregtar, sugjerojnë për ekzistencën me shumë mundësi të të ardhurave më të larta se ato të provuara ligjërisht, që duhet të kenë afektuar situatën financiare të familjes, duke bërë të mundur pagesën për blerjen e pasurisë “apartament” në rrugën “{***}”, Tiranë, me burimet e tyre financiare;

(iii) pavarësisht problematikës që ka rezultuar si pasojë e analizës financiare për provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave të personit të lidhur dhe prindërve të saj që kanë shërbyer si burime financiare për blerjen e kësaj pasurie, nga hetimi administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, nuk u ngritën dyshime për krijimin e këtyre të ardhurave nga aktivitete të kundërligjshme.

Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe qëndrimin e përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në konkluzionet përfundimtare, sipas të cilit, në kushtet kur problematikat e mësipërme lidhen me të ardhurat të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së personit të lidhur “apartament, me sipërfaqe 97,5 m², në rrugën “{***}” Tiranë”, krijuar para martesës ligjore me subjektin e rivlerësimit, vlerësohet se këto mangësi të vetme, nuk

konsiderohen të mjaftueshme si shkaqe objektive dhe proporcionale për të ngarkuar drejtpërdrejt subjektin e rivlerësimit me masë disiplinore, por duhen vlerësuar nga Kolegji në kuadër të një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë.

50. Për rrjedhojë, trupi gjykues, në vijim të sa më sipër, arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit Ervin Pollozhani ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve, provave dhe legjislacionit të zbatueshëm.
51. Në përfundim, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin nr. 689, datë 24.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ervin Pollozhani, për pasojë ai duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 689, datë 24.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ervin Pollozhani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 15.12.2025.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi